BPB

Banka e vendit tënd

BPB

Banka e vendit tënd

RAPORTI VJETOR

2020

BPB

Banka e vendit tënd

RAPORTI VJETOR 2020

BPB

Banka e vendit tënd

PËRMBAJTJA

LETRA E KRYETARIT TË BORDIT 5

LETRA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV 7

STRUKTURA ORGANIZATIVE 9

REZULTATET FINANCIARE SIPAS IFRS-SË 13

KLIENTËT E BIZNESIT DHE INDIVIDUAL 17

MENAXHIMI I RIKSUT 23

BURIMET NJERËZORE 27

PAJTUESHMËRIA DHE AML 33

ZHVILLIMI I PRODUKTEVE DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE 37

PËRGJEGJËSIA SOCIALE 41

PASQYRAT FINANCIARE 45

LETRA E KRYETARIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Ansis Grasmanis

KRYETAR I BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar lexues,

Ne e filluam vitin tonë financiar 2020 me një performancë të fortë, para se bota të përjetonte probleme si rezultat i shpërthimit të pandemisë. Sigurisht, pandemia pati pasoja të konsiderueshme edhe për klientët tanë. Banka duhej të reagonte shpejt për t'u përballuar me mjedisin e ri që ndryshoi brenda natës dhe ndërmorri disa veprime për të ndihmuar klientët e saj të përballen me situatën e re.

Besimi im në aftësinë e bankës për të kapërcyer këtë periudhë të trazuar bazohet në strategjinë dhe progresin tonë që të vazhdojmë të ofrojmë shërbime duke përdorur praktika etike që janë bazat e biznesit tonë në ofrimin e asaj që është më e nevojshme për klientët tanë.
Gjatë tremujorit të dytë, 40% të klientëve të bankës iu dha një pauzë të standardizuar pagese prej 3 muajsh. Më tej, në tremujorin e tretë ne bëmë një vlerësim individual të më shumë se 300 klientëve që u përballën me më shumë vështirësi dhe si rezultat 7.7% e portfolios përfitoi plane të ristruktuara të pagesës.

Megjithëse ekonomia globale po rritet përsëri pas tkurrjes në vitin 2020, pandemia ka shkaktuar një barrë të rëndë për njerëzit në të gjithë globin për sa i përket biznesit dhe aktiviteteve. Pavarësisht nga pritjet për një aktivitet ekonomik dëshpërues dhe të ardhurave dëshpëruese për një periudhë të zgjatur, horizonti po duket më i qetë me futjen në përdorim të vaksinave. Nga ana tjetër, ekziston një trend pozitiv në të gjithë Evropën përmes një cikli të riinvestimit që synon rritje të qëndrueshme që është paralele me subvencionet e gjera të qeverive përmes pakove të rimëkëmbjes ekonomike. Kjo ka shumë të ngjarë të përmirësojë rritjen e përgjithshme ekonomike në vitin 2021, siç parashikohet nga FMN-ja dhe Banka Botërore. Brenda këtij mjedisi global, ekonomia e Kosovës u tkurr për 7% në vitin 2020, me rritjen që rifilloi në TM4.

PERFORMANCA GJATË VITIT 2020

Në përgjithësi, performanca e sektorit bankar ndoqi një trend të qëndrueshëm financiar dhe një mjedis relativisht të qëndrueshëm të tregut në Kosovë, pavarësisht nga situata pandemike. Totali i aseteve në sektorin bankar vazhdoi të rritet për 12.6% dhe arriti në 5.35 miliardë euro, gjë që tregon qëndrueshmëri në aspektin e depozitave duke arritur nivelin e 4.36 miliardë eurove. Kjo rritje është ndjekur gjithashtu nga një zhvillim i qëndrueshëm në portofolin e kredisë prej 7.1% që rezultoi në 3.25 miliardë euro, në të njëjtën kohë duke ruajtur cilësinë e mirë të portofolit me vetëm 2.7% në KJP, që vazhdon të jetë një nga më të mirat në rajon. Edhe BPB-ja ka treguar rezultate inkurajuese, veçanërisht në segmentet kyçe që janë segmenti i Klientëve Individual dhe segmenti i NMVM-ve. Në vitin 2020, fitimi neto i bankës kaloi pak më shumë se 4.5 milionë euro, një sukses i cili është i konsiderueshëm kur merret parasysh periudha e izolimit.

Bordi i Drejtorëve ka vlerësuar dhe konfirmuar rekomandimin e pagesës së dividendit për rezultatet financiare të vitit 2020 dhe ato të vitit 2019. Kjo falë pozicionit të fortë të kapitalit të BPB-së, diversifikimit të portofolit të kredisë dhe menaxhimit të kujdesshëm të rrezikut.

Qeverisja korporative dhe sistemet e kontrolleve të brendshme kanë përparuar dhe janë forcuar. Tre profesionistë të rinj të pavarur iu bashkuan Bordit të Drejtorëve, duke dhënë një shembull të mirë të një përbërjeje mjaft të larmishme profesionalisht. Përmirësimet e qeverisjes korporative që korrespondojnë me rritjen e bankës do të ndikojnë në rritjen e vlerës afatgjatë të aksionarëve dhe do ta ngrisin bankën në nivelin tjetër. Për të arritur këto nivele, banka filloi të masë kënaqshmërinë e klientëve dhe të punonjësve duke përdorur metodologjinë Net Promoter Score (NPS). Rezultatet treguan një rritje të ndjeshme drejt fundit të vitit në të dy grupet. Këtë vit, ne kemi dëshmuar qëndrueshmërinë e vazhdueshmërisë së operacioneve dhe modelit të biznesit tonë, të mbështetur nga angazhimi jonë me klientët tonë, angazhim ky që do ta ndjekim nga afër edhe në të ardhmen.
Çdo krizë që kapërcejmë do të na bëjë më të fortë për të ardhmen dhe ky vit nuk ka përbërë përjashtim për BPB-në. Falënderoj aksionarët për mbështetjen e tyre, menaxhmentin ekzekutiv për udhëheqjen, të gjithë kolegët për përkushtimin dhe angazhimin e tyre për t'ia mundësuar bankës të kalojë përmes një viti të trazuar, duke siguruar kështu qëndrueshmërinë dhe njohuritë praktike të bankës për një rritje afatgjatë të qëndrueshme dhe fitimprurëse.

Në emër të Bordit të Drejtorëve,

Ansis Grasmanis
Kryetar i Bordit të Drejtorëve

LETRA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Arton Celina
CHIEF EXECUTIVE OFFICER

Të nderuar lexues,

2020 nuk bëri përjashtim për Kosovën e as për bankën tonë, ashtu si për të gjithë industrinë bankare në të gjithë globin, prandaj jemi të kënaqur që po shkojmë drejt një viti 2021 më prosperues. Në shumë aspekte, sektori financiar është goditur thellë ndërsa kalonte përmes një mjedisi me stres test real ku u testuan sistemet e brendshme të bankave dhe ne jemi të lumtur këtu në BPB që të gjitha sistemet thelbësore, përfshirë likuiditetin dhe rikuperimin e kredisë, u treguan të shëndosha dhe të qëndrueshme. Rrjedhimisht, BPV-ja e vendit u tkurr për 7.3% në terma vjetor në tremujorin e tretë të vitit 2020, pastaj u rrit gradualisht gjatë tremujorit të fundit, gjë që na bën të mendojmë se kohët në vijim do të jenë trende rritëse në shumë industri me një zgjerim të konsiderueshëm duke marrë parasysh rënien përgjatë pandemisë. Megjithatë, ndikimi i rënies ekonomike do të ndihet gjatë gjatë kohës në vijim, e që do të kërkoj përpjekje të mëdha nga të gjithë palët e interesuara, përfshirë sektorin financiar.

Mjedisi i biznesit kaloi nëpër një ndryshim të rëndë duke nënvizuar se disa sektorë, për shkak të aktiviteteve specifike, u goditën drejtpërdrejt nga kërkesa më e ulët ose kufizimet nga masat kundër COVID-19. Sektorët si ndërtimtaria dhe gastronomia u prekën shumë dhe ndikuan jo vetëm në uljen e kërkesës për kredi në sektorin bankar por edhe në uljen e kapaciteteve konsumuese në shumë sektorë të tjerë. Si rezultat, më shumë se 30% e aktiviteteve të biznesit kaluan në mënyrën e mbijetesës duke ulur ndjeshëm numrin e punonjësve të tyre për shkak të operacioneve nën kapacitetet e tyre të plota. Falë pozicionimit tonë strategjik, këto kohë ndëshkuese gjetën BPB-në me një portofol shumë të larmishëm që nuk përbënte kërcënime ekzistenciale për Bankën pasi shumica e portofolit të biznesit u ishte alokuar NMVM-ve që ishin mjaft më të shkathëta dhe të afta për t'u përshtatur me situatën e krijuar nga pandemia.

Banka vazhdoi përmes një rritje të kontrolluar duke i qëndruar besnike modelit të saj të biznesit në shërbimin e klientëve individualë dhe NMVM-ve.

Deri në fund të vitit, BPB-ja u rrit për 6.7% sa i përket kredisë, që rezultoi në një portofol total të kredive prej afër 200 milion euro, gjë që ngre Bankën në një nivel më të lartë për sa i përket konkurrencës dhe në raport me nevojat e klientit. Të ardhurat nga interesi në shumën prej 15.6 milion euro, krahasuar me 14.8 milionë euro në vitin 2019, kombinuar me raportin e zvogëluar të kostos ndaj të ardhurave prej 50.5% krahasuar me 52.5% të një viti më parë, ia mundësuan Bankës të mbante nën kontroll të gjitha operacionet gjatë gjithë vitit. Njëkohësisht, depozitat e klientëve luajtën një rol vendimtar në stabilitetin e Bankës, duke mundësuar qasje të vazhdueshme në financa për të gjithë klientët tanë. Rritja prej 13.8% sa i përket depozitës ndërsa tejkalonte 288 milionë euro, krahasuar me 254 milionë euro vitin e kaluar, ishte një arritje e jashtëzakonshme. Rrjedhimisht, kapitali i përgjithshëm i Bankës u rrit në 35.6 milionë euro, nga 31.1 milionë euro në vitin e kaluar.

Fuqia e kapitalit të qëndrueshëm dhe menaxhimi i kujdesshëm i rrezikut, për sa i përket provizionimit të mjaftueshëm, i mundësuan bankës zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve bankare cilësore për klientët tanë, në të njëjtën kohë duke menaxhuar pritjet e tyre gjatë pandemisë. Për më shumë se 60% të klientëve të biznesit, banka jonë ka zgjatur pagesat e tyre sipas udhëzimeve të BQK-së dhe kërkesave rregullatore, që rezultoi në plane të sakta pagese, pasi që vetëm 7% kaluan në valën e dytë të moratoriumeve, gjë që rezultoi në nivel të ulët të KJP-ve prej vetëm 2.68%.

Mbështetja dhe sigurimi i mirëqenies së bizneseve, në të njëjtën kohë duke gjeneruar në mënyrë efektive të ardhura të besueshme në sektorët kryesorë, na siguron që BPB-ja do të mbetet kompakte dhe e palëkundur drejt arritjes së rezultateve më të mëdha në vitet që po vijnë. Përveç cilësisë së portofolit dhe aktiviteteve të tjera bankare, ne e shfrytëzuam këtë kohë në avantazhin tonë si një mundësi për të reflektuar mbi shumë procese dhe sisteme të brendshme dhe për të ridizajnuar ciklin e proceseve që përshtaten më mirë me modelin aktual të biznesit operativ si dhe mundësojnë zgjerimin e limiteve institucionale. Prandaj, për vitin e ardhshëm ne planifikojmë të zgjerojmë gamën tonë të ofertave dhe jo vetëm në shërbimet bankare.
Për vitin intenziv që kërkonte aktivitete të orkestruara mirë duke marrë parasysh biznesin dhe mjedisin financiar, dëshiroj ta falënderoj stafin tonë për përpjekjet e tyre të palodhshme dhe punën e mirë që e ka bërë, aksionarët tanë për mbështetjen dhe besimin e tyre në BPB, dhe shpreh mirënjohjen time për klientelën tonë që na besoi gjatë periudhave kur kjo ishte më e rëndësishme.

Në emër të BPB,

Arton Celina
Kryeshef Ekzekutiv

STRUKTURA ORGANIZATIVE




KOMITETI I RISKUT
KOMITETI I BURIMEVE NJERZORE
KOMITETI I AUDITIMIT
ZV. KRYESHEFI EKZEKUTIV
DEPARTAMENTI I AUDIMIT TË BRENDSHËM
DEPARTAMENTI PËR ADMINISTRIM TË KREDIVE
DEPARTAMENTI I PAJTUESHMËRISË
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË LLOGARIVE
DEPARTAMENTI I RISKUT
DEPARTAMENTI I TI
DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME
DEPARTAMENTI I THESARIT
ZHVILLIMI I PRODUKTEVE

BPB

Banka e vendit tënd

REZULTATET FINANCIARE SIPAS IFRS-së

Përkundër një viti të vështirë që lame pas, BPB edhe përgjatë vitit 2020 ka shënuar një vit të suksesshëm, duke rezultuar me një performancë financiare stabile, e shprehur kjo në treguesit kyç financiar të bankës sonë.

Në vitin 2020 u arrit fitimi neto prej 4.5 milion euro duke rritur kështu ekuitetin e aksionarëve nga 31.1 milion euro sa ishte në vitin 2019, në 35.6 milion euro në fund të vitit 2020. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar ishte 13.6% këtë vit dhe 22.8% në vitin e kaluar. Treguesit e adekuatshmërisë së kapitalit u mbajtën stabil, ku gjithsej kapitali mbi mjetet e peshuara me rrezik ishte 17.76%, ndërsa për vitin 2019 ishte 15.73%.

Gjatë vitit 2020, BPB realizoi të hyra neto nga interesi në shumë prej 13.3 milion euro duke shënuar kështu një rritje prej 0.9 milion euro, apo rritje prej 7.3%, krahasuar me 12.4 milion euro sa ishin në vitin 2019.

Shpenzimet e interesit për vitin 2020 ishin rreth 2.3 milion euro. Margjina neto e interesit në vitin 2020 ishte 6.3%, nga 6.6% sa ishte në vitin paraprak, si pasojë e rënies së normës së interesit në kredi. Kategoria e dytë e të hyrave për nga madhësia janë të hyrat neto nga tarifat dhe komisionet të cilat arritën nivelin prej 2.3 milion euro, te cilat kane shënuar rritje krahasimisht me vitin e kaluar prej 17.3%. Shpenzimet operative gjatë vitit 2020 u rritën për 0.4% krahasuar me vitin 2019.

Raporti i kostove operative mbi të hyrat operative shënoi një përmirësim nga 52.5% sa ishte në vitin 2019 në 50.5% në vitin 2020.

Edhe gjatë vitit 2020, BPB vazhdojë të rrisë portfolion bruto të kredive, me një rritje prej 12.5 milion euro, duke arritur kështu në 200 milion euro në fund të vitit 2020. Investimet në letra me vlerë dhe obligacione qeveritare të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2020, u rritën për 14.9 milion euro duke rezultuar në 53.5 milion euro në fund të vitit 2020, nga 38.6 milion euro sa ishin në vitin paraprak. Duke diversifikuar edhe më tej strukturën e depozitave dhe qëndrueshmërinë e vazhdueshme të fondeve të reja, BPB gjatë vitit 2020 shënoi një rritje të konsiderueshme të bazës së depozitave prej 34.9 milion euro.

BPB

Banka e vendit tënd

KLIENTËT E BIZNESIT DHE KLIENTËT INDIVIDUAL

Duke qenë vit i brishtë në aspektin ekonomik, i shkaktuar nga përhapja e pandemisë COVID-19 në të gjithë botën, industria bankare në vend dhe në të gjithë botën është sfiduar thellësisht në shumë aspekte. Sektori bankar kaloi nëpërmes një stres testi dhe ambienti të vështirë ku u testuan sistemet e brendshme të bankave dhe ne jemi të lumtur si BPB që të gjithë indikatorët kryesorë, përfshirë likuiditetin dhe arkëtimin e kredive, rezultuan jashtëzakonisht solventë dhe të qëndrueshëm.

Viti 2020 ka sfiduar BPB-në në të gjitha indikatorët e mundshëm, si nga ana financiare ashtu edhe nga pikëpamja e menaxhimit të situatës së krijuar që tashmë përbën një realitet të ri në mjedisin biznesor. Përkundër këtij fakti, BPB-ja ka vazhduar me zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore bankare të cilat janë përcaktuar në modelin e saj të biznesit. Në këtë drejtim, shërbimi i bizneseve mikro, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) si dhe për personat individualë (PI) ka vazhduar të jetë në fokusin e bankës edhe pse me disa objektiva më ndryshe karshi menaxhimit të situatës.

Si fokus primar i BPB-së ka qenë menaxhimi i pandemisë, duke përfshirë edhe kërkesat e rregullatorit për prolongimet/ristrukturimet dhe ndryshimet tjera të nevojshme të cilat janë realizuar me përkushtim të madh nga stafi i bankës, i cili ka qenë i angazhuar në bashkëpunim me klientët tanë për të kaluar sa më lehtë këtë sfidë. Departamentet përkatëse, përfshirë ata të Biznesit dhe Riskut, kanë analizuar të gjithë portofolin ekzistues, me ç'rast kemi dalë me analizën e parë të tregut dhe efekteve të pandemisë mbi bizneset kosovare, me fokus të veçantë tek NVM-të. Ky studim është përdorur edhe nga partneret tanë dhe na ka shërbyer edhe si udhëzues për veprimet adekuate për bankën dhe klientët tanë. Kemi aprovuar dhe u kemi mundësuar klientëve tanë qasje në financa përkundër ngecjes në biznes, me të vetmen arsye që ata ta kalojnë më lehtë periudhën e mosfunksionimit të ekonomisë. Rreth 60% të portofolit të kredisë në sektorin e bizneseve është prolonguar, varësisht prej nevojave të klientit, duke ia lehtësuar mënyrën e pagesës në kohën e bllokimit si pasojë e pandemisë. Vetëm 10% të biznesve kanë pasur probleme në datën e arritjes së kësteve, që nënkupton se zgjidhjet dhe modalitetet e ofruara për klientët tanë kanë qenë të qëlluara.

Në vazhdën e punëve të bankës ka qenë edhe momenti i duhur që BPB-ja të fillojë të përgatisë infrastrukturën për qasje nga distanca në shërbimet e bankës. Kjo për arsye se efektet e pandemisë kanë bërë që shumë klientë të preferojnë shërbimin nga shtëpia në vend të atyre në zyrat e bankave. Edhe nga ana e rregullatorit kemi hasur në një gatishmëri dhe përkrahje në këtë drejtim, ndaj edhe kemi prezantuar mundësi për aplikim të shërbimeve bankare përmes kanaleve alternative dhe faqes sonë në internet. Për më shumë, kemi përgatitur edhe investime të reja në staf dhe infrastrukturë, të cilat në të ardhmen e afërt do të na shërbejnë si mënyrë e preferuar e shërbimit në bankë.

Përgjatë vitit 2020 ka qenë e domosdoshme që objektiv parësor ta kemi gatishmërinë dhe komunikimin me klientët tanë të cilët jo rrallëherë e kanë pasur të pamundur ardhjen në bankë. Si zgjidhje, BPB ka trefishuar kapacitetet në qendrën e thirrjeve me qëllim që të ofrojmë sqarimet dhe asistencën e nevojshme për klientët tanë. Suksesi i këtij projekti më së miri shpjegohet edhe përmes matjes se kën-

aqshmërisë së klientëve përmes hulumtimit 'Net Promoter Score' (NPS). Përderisa gjatë muajve më të rënd (mars-qershor) ky indikator ka rënë në të gjithë tregun bankar, në fund të vitit ka shënuar një rritje të ndjeshme, me BPB-në njërin nga liderët në treg me 34%, bazuar në një hulumtim të pavarur të organizuar nga institucion hulumtues.

Paralelisht, situata ka sfiduar edhe stafin në shërbim të klientëve, të cilët me vetëmohim kanë qëndruar në gatishmëri dhe në shërbim të klientelës, duke ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme, përfshirë këtu edhe një pjese të madhe të grupeve të shoqërisë të cilë kanë qenë përfitues të skemave sociale në kuadër të pakove të rimëkëmbjes dhe të cilët nuk kanë pasur çasje në sistemin bankar. Përveç punëve dhe aktiviteteve ditore, një numër i stafit, gjatë vitit është përgatitur në ofrimin e shërbimeve jofinanciare për vitin e ardhshëm. Është mbajtur trajnimi me kompaninë e jashtme që për qëllim ka pasur përgatitjen e stafit të BPB-së në ofrimin e zgjidhjeve jofinanciare për klientët tanë, e kjo do të përcillet edhe përmes akademive të biznesit të cilat do të mbahen gjatë vitit 2021 dhe do të jenë një prej vlerave të shtuara në ekonominë e vendit nga Banka.

Banka ka vazhduar bashkëpunimin me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) duke rritur limitin për biznese dhe agrobiznese. Përmes këtij fondi ne kemi arritur të financojmë një numër të konsiderueshëm të klientëve NMVM dhe agrobiznese, të cilët kanë pasur barriera financimi për shkak të mungesës së kolateralit ose hipotekës. Këto financime në kuadër të FKGK-së kanë ndihmuar bizneset në fjalë që të vazhdojnë dhe zgjerojnë kapacitetet e tyre më tutje.

BPB-ja ka një strategji të veçantë për agrobiznesin për shkak se ne konsiderojmë një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe që ndikon në rritjen e punësimit në vend. Ky sektor merr pjesë me mbi 10% në bruto prodhimi vendor (BPV) në e vendit. Edhe pse një vit i ndikuar nga pandemia, agrobiznesi ka shënuar rritje të lehtë gjatë vitit 2020. Banka ka vazhduar ofrimin e shërbimeve dhe të produkteve kreditore bazuar në kërkesat e agrobizneseve me qëllim të përkrahjes dhe ngritjes së kapaciteteve të tyre.

Në drejtim të performancës së bankës, marrë parasysh të gjitha rrethanat, viti 2020 karakterizohet si vit i suksesshëm . Pas lirimit të masave në valën e parë në kuartalin e tretë është rikthyer fokusi i bankës në financimin e klientëve privat dhe klientëve të biznesit. Si rrjedhojë e rritjes së aktivitetit të bankës kemi lansuar kampanja specifike për klientët privat me norma atraktive të interesit por edhe lehtësime në kërkesën e bankës për kolateral. Ndërsa, për biznese kemi krijuar lehtësime për marrjen e kredive të cilat zakonisht ndërlidhen me kërkesat për kolateral. Por, krahas lehtësimeve kemi vazhduar me aprovimin e limiteve të paracaktuara nga banka sipas nevojës së klientëve tanë të drejtuar kryesisht në përmirësimin e ciklit të likuiditetit.

Si rezultat i këtyre kampanjave, rreth 70% e rritjes totale të portofolit është arritur në tremujorin e katërt. Në këtë rritje prej 15 milion euro marrin pjesë kreditë e personave individualë me 80%, ndërsa kemi pasur një rritje të moderuar në anën e biznesit duke mbajtur gjithmonë në kontroll kualitetin e portofolit.

Pozicionimi i BPB-së, si bankë e fokusuar tek biznet MNVM dhe klientët individual, ka ndikuar në zhvillimin e mëtutjeshëm, gjë që ka reflektuar edhe në besueshmërinë e klientëve ndaj bankës. Kjo ka bërë që të kemi një rritje të qëndrueshme në depozita përkundër situatës së krijuar. Gjatë vitit 2020, depozitat e Bankës janë rritur për 34.9 milion euro, respektivisht 13.75%, dhe kjo rritje ka ardhur kryesisht në llogari rrjedhëse prej klientëve individual.

BPB-ja ka vazhduar të sjellë risi sa i përket pakove bankare për biznese të cilat janë dizajnuar në mënyrë shumë transparente e të cilat ua mundësojnë klientëve t'i zgjedhin vetëm ato shërbime që ua plotësojnë nevojat e tyre. Duke pasur parasysh fokusin tonë në ngritjen e kualitetit të shërbimeve dhe produkteve të reja, të cilat lehtësojnë biznesin e klientëve tanë, ne jemi në proces të finalizimit të klasifikimit kreditor. Kjo do t'u mundësojë klientëve

DEPOSITS



*në 000

qasje të shpejtë në kredi duke ua mundësuar aplikimin përmes kanaleve alternative, gjë që kontribuon dukshëm në përmirësimin e kohës së shërbimit ndaj këtyre klientëve. Ky proces mundësohet si përmes faqes në internet ashtu edhe, në të ardhmen, përmes platformave tjera elektronike E-Banking ose M-Banking.

Banka jonë vazhdon të ketë në fokus ngritjen e shërbimeve elektronike duke e rritur efiçiencën dhe kursimin e kohës për klientët tanë. Në këtë aspekt ne kemi vazhduar t'i shtojmë shërbimet tona në platformat elektronike E-Banking dhe M-Banking, të cilat janë shumë praktike për përdoruesin. Numri i klientëve që përdorin platformat M-Banking dhe E-Banking ka shënuar rritje për 65.04%. Për më tepër, sa i përket shërbimeve elektronike, BPB-ja është banka e parë e cila ka shtyrë tutje edhe më shumë përdorimin e shërbimit të kartelave pa kontakt (contactless) në bankomat, shërbim i cili ua lehtëson edhe më shumë klientëve ekzekutimin e transaksioneve ditore.

shumë përdorimin e shërbimit të kartelave pa kontakt (contactless) në bankomat, shërbim i cili ua lehtëson edhe më shumë klientëve ekzekutimin e transaksioneve ditore.

BPB

Banka e vendit tënd

MENAXHIMI I RREZIKUT

Viti 2020 ishte një vit krejtësisht ndryshe nga aspekti i menaxhimit të rrezikut, ku përveç menaxhimit të punëve dhe proceseve të rregullta, ky vit u karakterizua edhe me dy procese të rëndësishme:

- implementimi i rregulloreve të reja nga BQK-ja, dhe
- menaxhimi i pandemisë COVID-19.

Më 1 janar 2020 ka hyrë në fuqi rregulloret që lidhen me menaxhimin e rrezikut kreditor, duke përfshirë edhe rregulloren për aplikimin e standardit IFRS 9 dhe rregulloren për ekspozimet joperformuese dhe ristrukturimet. Kjo ka vazhduar me rregulloren për adekuatshmërinë e kapitalit, si dhe ate për procesin e brendshëm të mjaftueshmerisë së kapitalit - ICAAP. Për të gjitha këto kërkesa të reja rregullative banka ka bërë përgatitjet e nevojshme dhe i ka implementuar me kohë.
Sa i përket menaxhimit të pandemisë COVID-19, ende pa u shfaqur rastet e para në Kosovë banka ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për përgatitjen e një plani të reagimit i cili ka paraparë masat që duhet ndërmarrë varësisht prej zhvillimeve dhe përhapjes së pandemisë. Masat e ndërmarra nga banka kanë qenë gjithëpërfshirëse, duke adresuar ndër të tjera: menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e relacionit me klientë, menaxhimin e relacionit me furnitorët si dhe menaxhimin e proceseve të brendshme të bankës. Në kuadër të këtij plani është krijuar Ekipi për Reagim i përbërë nga anëtarë të menaxhementit ekzekutiv dhe departamenteve tjera relevante. Në lidhje me menaxhimin e rrezikut gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Riskut ka qenë pjesë përbërëse dhe njëri nga akterët kryesorë në përpjekjet e bankës për menaxhimin dhe reagimin ndaj rreziqeve të krijuara si rezultat i COVID-19.

Në aspekt të menaxhimit të rrezikut operacional janë marrë hapat e nevojshëm për zbatimin e masave të sigurisë për stafin, ashtu që të sigurohet vazhdimësia e aktiviteteve operacionale të bankës. Ndër aktivitetet e ndërmarra me këtë rast kanë qenë: puna nga shtëpia për një pjesë të stafit, krijimi i mekanizmave dhe implementimin e masave për të siguruar mbrojtjen e stafit nga përhapja e pandemisë, krijimi i planit suksesor për stafin kritik, krijimi i udhëzimeve vetëdijësuese për mbrojtje nga përhapja e pandemisë dhe ofrimi i sesioneve informuese për stafin e angazhuar nga shtëpia për mbrojtjen nga sulmet kibernetike. Sa i përket relacionit me klientë dhe furnitorë, është bërë identifikimi i furnitorëve kritikë dhe monitorimi i aktiviteteve të tyre për sigurimin e vazhdimësinë e biznesit. Për më shumë, banka ka zhvilluar dhe përmirësuar me tutje platformat e saj elektronike ashtu që klientëve të saj t'u ofrohen shërbimet me lehtësi dhe shpejtësi, pa pasur nevojë të vijnë fizikisht në bankë.

Në mënyrë që të sigurohet se banka është në çdo kohë likuide, gjatë kësaj periudhe janë implementuar masa të ndryshme për të kontrolluar rrjedhën e parasë. Në baza ditore janë përcjellë për së afërmi indikatorët e likuiditetit, shfrytëzimi i mjeteve të kredisë, tërheqjet e depozitave, transferet jashtë bankës, dhe pozicione tjera relevante për likuiditetin e bankës. Në këtë aspekt, me qëllim që të sigurohet se BPB do të këtë mbulueshmëri të mjaftueshme me likuiditet, edhe në situatë të përkeqësuar, janë realizuar stres teste të cilat kanë kaluar me sukses. Gjatë kësaj periudhe është testuar edhe plani rezervë i likuiditetit me qëllim që të jemi të përgatitur në rast se do të kishte nevojë që të aktivizohet.

Sa i përket menaxhimit të rrezikut kreditor, në linjë me vendimet e Qeverisë së Kosovës dhe BQK-së për ofrimin e masave lehtësuese për individët dhe bizneset e afektuara nga pandemia, gjatë periudhës mars-qershor 2020 banka ka bërë shtyrjen e kësteve për klientët e saj konform kërkesave të tyre. Në këtë drejtim, banka ka ndjekur dy qasje, ku një njërën anë ka bërë vlerësime individuale për klientët në diskutim të drejtpërdrejt me klientët për të kuptuar qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e tyre, ndërsa në anën tjetër është bërë edhe vlerësimi i portfolios kreditore në kuadër të segmenteve dhe impaktit të vendimeve të Qeverisë sa i përket operimit të bizneseve. Në kuadër të fazës së dytë, nga muaji qershor 2020 deri në fund të muajit shtator banka ka bërë ristrukturimin e kredive sipas kërkesës së klientëve, me ç'rast janë analizuar të gjitha rastet individualisht duke përpiluar analiza financiare për klientët ashtu që të ofrohet mundësia që do t'i përshtatej klientëve më së miri me qëllim që të mbështetet rimëkëmbja e tyre. Të gjitha këto aktivitete janë bërë me qëllimin që të identifikohen segmentet dhe klientët potencialë që mund të kenë rritje në rrezikun kreditor ashtu që banka të marrë parasysh këtë rritje gjatë procesit të ndarjes së rezervave për kreditë.

Në mënyrë që menaxhimi i rrezikut kreditor të jetë sa më i mirë, ne vazhdimisht kemi realizuar stres teste për të kuptuar profilin e rrezikut kreditor dhe ekspozimin e bankës ndaj këtij rreziku. Këto stres teste kanë marrë për bazë supozime për përkeqësim të portofolit kreditor dhe të faktorëve makroekonomik. Bazuar në rezultatet e stres testeve është konkluduar se banka do të vazhdojë të jetë e mbuluar mirë me provizione për humbje nga kreditë dhe njëkohësisht do të jetë në pajtueshmëri me limitet e brendshme dhe ato rregullative. Përveç kësaj, gjatë kësaj periudhe kemi vazhduar ta mbajmë edhe më tutje kualitetin e kredive në nivele të kënaqshme. Pavarësisht kualitetit të kredive, Banka ka ndarë provizione mbi atë që ka qenë e kërkuar në mënyrë që të sigurojmë mbulueshmëri të mjaftueshme në rast të përkeqësimit të kredive si rezultat i impaktit të pandemisë.

Vlen të theksohet se për vitin 2020 Banka ka qëndruar mbi nivelin mesatar të sektorit bankar sa i përket mbulueshmërisë me provizione për kreditë. Gjatë kësaj periudhe, me qëllim të matjes së më të mirë të rrezikut, Banka është angazhuar edhe në analiza të industrive specifike duke bërë vlerësime në bazë të kritereve të ndryshme relevante. Banka ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme çdo vendim të Qeverisë lidhur me masat kufizuese dhe ka reflektuar në mënyrë dinamike ndryshimet e rrezikut të industrive ekonomike. Përmes analizave të industrive ekonomike, kemi parashikuar edhe skenarët e zhvillimeve të mundshme dhe në mënyrë korrelative kemi bërë edhe alokimin e rezervave të mjaftueshme me qëllimi të kapitalizimit sa më të mirë, ruajtjes së stabilitetit të bankës dhe përballimit të çfarëdo skenari të pafavorshëm.

BPB

Banka e vendit tënd

BURIMET NJERËZORE

Punonjësit tanë drejtojnë suksesin tonë. Shkathtësitë, përvoja dhe angazhimi i tyre na mundësojnë që ofrojmë produkte dhe shërbime inovative për klientët tanë. Si punëdhënës, ne tërheqim, zhvillojmë dhe mbajmë një gamë të larmishme të punësuarve, dhe synojmë të sigurojmë se BPB është një vend pune me kulturë të kujdesit që mbështet dhe angazhon punonjësit, duke iu mundësuar atyre të ndërtojnë karrierën e tyre dhe për të zbuluar potencialin e tyre të plotë.

Ne jemi të angazhuar për të krijuar mjedisin e duhur për të ndihmuar dhe të mundësojnë që të gjithë të përmbushin kapacitetin e tyre. Njerëzit tanë e dinë se mund të krijojnë karrierë të kënaqshme këtu, në sajë të kulturës sonë bashkëpunuese, suksesit të arritur dhe mundësive të shumta.

PUNËTORËT TONË NË NUMRA



NDIKIMI I COVID-19 DHE REAGIMI JONË

Përhapja e COVID-19, e klasifikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si një pandemi, ka pasur dhe vazhdon të ketë një ndikim të dukshëm tek njerëzit, bizneset, shoqëritë dhe ekonomitë në të gjithë botën.

Në këtë kohë pasigurie, fokusi ynë ka qenë në sigurimin e mirëqenies dhe shëndetit të stafit tonë. Kapitali njerëzor i shëndetshëm dhe i lumtur është thelbësor për një mjedis pune produktiv. Nga anketa e bërë nga Deloitte Albania & Kosovo për menaxhimin e situatës Covid-19, 78.2% e stafit tonë menduan se BPB, u siguron atyre mjetet e nevojshme dhe ka ndërmarrë masat dhe veprimet e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e punës edhe gjatë situatës së pandemisë. 85.5% e stafit tonë vlerësuan se ka një frymë të lartë ekipore dhe bashkëpunimi pavarësisht sfidave të krijuara nga pandemia.

Nga marsi, reduktuam numrin e punonjësve në zyrë për disa muaj me radhë, duke angazhuar rreth 150 staf të punojnë nga shtëpia dhe/ose duke punuar me rotacion, duke respektuar të gjitha masat e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e Covid-19. Ne krijuam Udhëzimin për Menaxhimit e Situatës Covid-19, duke përshkruar të gjitha udhëzimet brenda bankës për parandalimin e COVID 19 që nga pastrimi i duarve, mbajtja e distancës, maskave, zhvillimi i takimeve virtuale e deri tek takimet e jashtme.

ÇELSI PËR NJË KULTURË TË QËNDRUESHME / ARRITJET KRYESORE

Është vitale që të kuptojmë se si ndihen njerëzit tanë, pasi na ndihmon t'u japim atyre mbështetjen e duhur për të punuar dhe shërbyer sa më mirë klientët tanë. Ne kemi marr pikëpamjet e tyre në një varg temash, si: angazhimi i tyre, kultura, sjellja, udhëheqja, dhe mirëqenia jonë, përmes sondazhit të punonjësve nga Deloitte Albania & Kosovo. Pas pranimit të rezultatve, kemi punuar për të trajtuar temat dhe kemi modifikuar Menaxhimin e Performancës, duke zhvilluar dhe avancuar Udhëzimin për Menaxhim të Performancës, të cilin e kemi publikuar në nëntor të vitit 2020.

Hulumtimi Employee Net Promoter Score (eNPS) i bërë në vazhdueshmëri, hulumtim që tregon nëse kolegët do të rekomandonin BPB si një vend të mirë për të punuar, na mundëson të kuptojmë se si perceptohet banka dhe sa të lumtur janë njerëzit që punojnë këtu. Rezultatet e fundvitit 2020, tregojnë një rritje prej 31.8 pikë krahasuar me matjen e fundit që është bërë në dhjetor 2019.



Në dhjetor 2020, eNPS i bankës tonë ishte 36.4 që konsiderohet si notë 'e shkëlqyeshme' bazuar në parametrat matës të këtij hulumtimi.

Ky indikator tregon angazhimin e bankës në të gjitha dimensionet për të rritur motivimin dhe kënaqësinë e stafit në punë. Për të mbajtur motivimin e personelit ne nivele te kënaqshme edhe gjatë pandemisë, ne kemi organizuar aktivitet te ndryshme virtuale. Kemi organizuar edicion special të TAPQuiz në bashkëpunim me Gjirafa Videos i quajtur TAPn'BPB. Ishte një kuiz ku kolegët kanë matur njohuritë e tyre të përgjithshme, mirëpo edhe njohjen e historikut të bankës. Fituesit kanë marrë shpërblime, mirëpo ishte atmosfera e krijuar në bankë atë ditë që do të mbahet në mend nga gjithë ne. Realizuam edhe një garë të fotografisë më të mirë me titullin

"Moment në BPB" ku kolegët garuan duke dërguar fotografi të ilustruara me pamje të përditshmërisë në vendin e punës. Fushatat sensibilizuese si: #IWashMyHandsFor, #StrongerTogether, #BreastCancerAwarness, "Stay away becase I like you", u organizuan në mbështetje dhe vetëdijesim të kolegëve, të afërmve dhe shoqërisë tonë, e u prezantuan dhe u përkrahën edhe në rrjetet sociale të BPB Karriera.

BPB Karriera vazhdon të rritet dhe të ketë vëmendjen e palëve të jashtme duke u informuar edhe më shumë me ndodhitë e bankës. Në vitin 2020, kemi filluar edhe me publikimin e punonjësve tanë duke prezantuar histori të ndryshme dhe motivuese të tyre në BPB.

REKRUTIMI, ZHVILLIMI DHE MENAXHIMI I TALENTËVE

Ne synojmë që të jemi punëdhënës i zgjedhur dhe një vend pune për të ndërtuar karrierën. Çelësi i suksesit tonë është qëndrimi ynë ndaj angazhimit për të investuar në njerëzit tanë në çdo fazë të karrierës.

Fillojmë me rekrutimin, ku synojmë të punësojmë kandidatë potencial, duke marrë parasysh përvojën e individit dhe kompetencat, aftësitë për të mësuar dhe përshtatjen e shpejtë, si dhe ide të zhvillimit të proceseve. Në vitin 2020, ne kemi punësuar gjithsej 35 staf nga jashtë për dallim nga viti 2019 që ishin 42. Gjithashtu, kemi vazhduar rekrutimin e talenteve të rinj nga Programi BPB Juniors, duke punësuar 9 prej tyre gjatë vitit 2020. Për më shumë kemi punësuar 5 juniors të tjerë si praktikantë në degë të ndryshme në Kosovë për periudhë të caktuar.

BPB mbetet e përkushtuar ndaj strategjisë së rekrutimit dhe përgatitjes së të rinjve për tregun bankar, nëpërmjet programit BPB Junior. Ky program ju ofron të rinjëve që gjatë studimeve apo edhe pas diplomimit të mund të kalojnë nga studimi në fillimin e karrierës së tyre sa më lehtë. Duhet theksuar se në këtë vit, ne mbyllën programin e 3-të të Junior, nga i cili diplomuan 20 kandidatë.

TRAJNIMET DHE ZHVILLIMI I TË PUNËSUARVE

BPB investon vazhdimisht në staf që ata të zbulojnë potencialin e tyre të plotë. Në vitin 2020, janë promovuar gjithsej 28 punonjës, duke arritur të zhvillohen edhe më shumë personalisht dhe profesionalisht.
Ne besojmë se nëpërmjet punës së tyre të përditshme dhe mundësive të tjera si kërkesa shtesë, projekte të veçanta, lëvizje të brendshme dhe takime zyrtar dhe jo-formal, punonjësit tanë vazhdojnë të ndërtojnë aftësi të reja.

Trajnimi është gjithashtu një pjesë e rregullt e përvojës së secilit. Kemi vazhduar të zhvillojmë trajnime që të gjithë punonjësit duhet ndjekur për pajtueshmëri, menaxhimin e riskut operacional dhe vazhdimësisë së biznesit, AML-së, e tema të tjera. Në vitin pandemik, trajnimet direkt kanë qenë dukshëm dhe kuptueshëm më të vogla në numër, megjithatë është rritur pjesëmarrja në trajnime virtuale dhe kurseve online.

Ndërtimi i aftësive dhe zhvillimit në karrierë, është mbështetur gjatë vitit 2020, duke trajnuar dhe zhvilluar pozitat senior potencial në degë, duke promovuar punonjësit dhe lëvizje të pozitave të brendshme. Qëllimi jonë është që të paktën çdo vit të punësuarit nëpërmjet Menaxhimit të Performancës të flasin me përgjegjësin e tyre për zhvillim dhe avancim.

RËNDËSIA E DIVERSITETIT DHE PËRFSHIRJES

Puna në BPB, përfshinë zhvillimin e marrëdhënieve me njerëz me histori dhe kultura të ndryshme, e që janë shumë të rëndësishme për suksesin tonë afatgjatë. Për këtë, përpiqemi të formojmë një kulturë gjithëpërfshirëse dhe ofrojmë mundësi të barabarta të promovimit.

Ne mbetemi të përkushtuar për të ngushtuar hendekun e përfaqësimit gjinor, veçanërisht në nivelin e menaxhmentit, përmes një kulture të diversitetit gjinor dhe mbështetjen e iniciativave për të punësuar, promovuar dhe mbajtur më shumë femra në të gjitha nivelet e institucionit tonë.

Në vitin 2020, 48% e të gjithë punonjësve kanë qenë femra. Për më tepër, ne vazhdojmë të rrisim përfaqësimin e femrave në rolin menaxhues i cili aktualisht qëndron në 43%, ndërsa në Bordin Drejtues kemi 29% femra.



BPB

Banka e vendit tënd

PAJTUESHMËRIA DHE AML

AML

Objektivi i Bankës për Biznes vazhdon të jetë respektimi i rregulloreve dhe ligjeve aktuale vendore, direktivave dhe rregulloreve të BE-së, si dhe i praktikës më të mirë ndërkombëtare siç është përcaktuar nga Financial Action Task Force (FATF). Për më shumë BPB vepron çdo herë në përputhje me detyrimet ligjore (Ligji nr. 05/L-096) dhe aktet e tjera nënligjore për parandalim të pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Gjatë vitit 2020, Departamenti i AML-së ka zbatuar programin i cili përmban rregulla të brendshme në aspektin e parandalimit, zbulimit dhe raportimit të transaksioneve të dyshimta për pastrim të parave.

Ndër të tjera, fokusi i Bankës ka vazhduar të jetë identifikimi i klientëve, e kjo me qëllim që Banka të ketë sa më shumë informata për profilin e klientëve dhe aktivitetin e biznesit në mënyrë që të eliminohet çdo kërcënim i mundshëm i pastrimit të parave, dhe të ndërtohet një marrëdhënie me klientë bazuar në besim dhe transparencë.

Përmes mbështetjes së aplikacionit ASEBA - AML i cili përdor zgjidhje sistematike, të dhënat e transaksionit integrohen me informacionin mbi përdoruesit. Kjo rezulton në një pasqyrë të plotë të aktiviteteve brenda sistemit dhe mundëson identifikimin e saktë dhe korrekt të aktiviteteve të dyshimta, gjë që mundëson monitorimin dhe identifikimin e vazhdueshëm të pastrimit të mundshëm të parave dhe financimit të terrorizmit.

PAJTUESHMËRIA

Banka për Biznes, si një bankë e orientuar në zhvillim, ka për qëllim kryerjen veprimtarive të përgjegjshme bankare duke vepruar në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira vendore dhe ndërkombëtare të pajtueshmërisë.

Aktivitetet e saj të biznesit zhvillohen në mënyrë etike, duke vendosur në prioritet klientin dhe krijimin e marrëdhënies së biznesit nën aplikimin e pakushtëzuar të kornizës rregullative.
Në BPB, Pajtueshmëria është e organizuar si funksion i pavarur dhe është e vendosur në nivelin e menaxhmentit të lartë. Ky funksion ndihmon menaxhmentin ekzekutiv në mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së përgjithshme të bankës dhe i mban të informuar dhe të përditësuar mbi zhvillimet dhe/ose praktikat më të mira në pajtueshmërinë dhe shqyrton këto zhvillime dhe/ose praktika për aplikueshmërinë në Bankë.

Funksioni i Pajtueshmërisë raporton te Bordi Drejtues mbi gjendjen e aktiviteteve të pajtueshmërisë në bankë. Në këtë aspekt i jep rekomandime Bordit Drejtues se si të zhvillojnë (më tej) dhe të përmirësojnë përgjithësisht pajtueshmërinë me kornizën rregullative të BQK-së.
Në Bankën për Biznes, e gjithë korniza e dokumenteve të brendshme është krijuar në frymën e ligjeve dhe rregullave të zbatueshme vendore, duke vendosur fokusin në kërkesat për t'iu përgjigjur rreziqeve të ndryshme të pajtueshmërisë ndaj të cilave banka mund të ekspozohet.

Përveç kësaj, Funksioni i Pajtueshmërisë në vazhdimësi monitoron dhe sfidon në mënyrë të pavarur shkallën në të cilën banka është në përputhje me kornizën rregullative.

BPB

Banka e vendit tënd

ZHVILLIMI I PRODUKTEVE DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Krahas ndikimit të përgjithshëm të pandemisë në mënyrën e të bërit biznes, edhe sektori bankar u ballafaqua me rrethanat e reja dhe në linjë me to u detyrua të prezantojë mënyra të përshtatshme për të siguruar mbarëvajtjen e proceseve operacionale dhe ofrimin e shërbimeve për klientë përmes kanaleve alternative.

Në këtë drejtim, BPB ka mundësuar realizimin e pothuajse të gjitha llojeve të transaksioneve përmes kanaleve elektronike, me ç'rast investimet dhe zhvillimet e realizuara ndër vite kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e përdorshmërisë së tyre, duke promovuar kështu përgjegjësinë sociale dhe duke shmangur vizitat e klientëve në degë. Sigurimi i funksionalitetit të lartë të kanaleve elektronike ka qenë një ndër objektivat kryesore të këtij viti, prandaj janë ndërmarrë një sërë angazhimesh dhe investimesh me ndikim direkt në ngritjen e performancës. Investimi në mekanizmat e monitorimit të funksionalitetit të shërbimeve në kohë reale, realizimi i kontrolleve më të shpeshta preventive dhe ripërtëritja e pjesëve përcjellëse kanë pasur efekt pozitiv në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe stabile 24/7.

Me të njëjtin ritëm është punuar në projekte të optimizmit të sistemeve kyçe të bankës duke ngritur nivelin e disponueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre. Po ashtu, është punuar në zhvillimin e veglave të cilat ndihmojnë në automatizimin e proceseve komplekse të raportimit tek rregullatorët si dhe monitorimit dhe njoftimit në kohë reale për problemet eventuale në shërbime të ndryshme.

Në linjë me avancimet teknologjike, BPB-ja ka vazhduar të mbajë në fokus zhvillimin e produkteve dhe teknologjinë e informacionit.

Si rrjedhojë, edhe gjatë këtij viti është punuar në zgjerimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve ekzistuese me qëllim të përmbushjes së pritjeve të klientëve, për të ofruar kualitet dhe komoditet gjatë bankimit. Përveç avancimeve në disa nga funksionalitetet ekzistuese, është thjeshtësuar mënyra e realizimit të transaksioneve përmes platformave elektronike E-Banking dhe M-Banking, duke mundësuar administrim më të shpejtë dhe më efikas të financave. Për më tepër, janë bërë investime në ngritje të nivelit të sigurisë dhe përmirësim të performancës së aplikacioneve duke ngritur dukshëm shpejtësinë e reagimit të aplikacionit.

Rrjeti i bankomatëve dhe kartelave ka dëshmuar të jetë një ndër akterët kryesor drejt rrugëtimit digjital të sektorit bankar, duke hapur rrugën për vazhdim të transformimit të mëtutjeshëm. Si rrjedhojë, edhe këtë vit janë bërë investime në zgjerimin e gamës së shërbimeve dhe ngritjen e sigurisë së transaksioneve me kartela. Konkretisht, BPB-ja ka implementuar funksionalitetin e deponimit pa kontakt në bankomatë, duke u bërë kështu banka e parë në treg që ofron këtë shërbim.

Në anën tjetër, vlen të potencohet edhe implementimi i versionit të ri të shërbimit "3D Secure" për parandalimin e përdorimit të paautorizuar të kartelave gjatë realizimit të transaksioneve online bazuar në sjelljen e klientit.

Operimi në një ambient të imponuar nga rrethanat e krijuara dhe fleksibiliteti i treguar gjatë kësaj periudhe vë në pah rolin dhe rëndësinë e teknologjive të reja në ditët e sotme, si pikënisje dhe domosdoshmëri në rrugëtimin tonë drejt çfarëdo zhvillimi apo ndryshimi të mëtejmë.

Në këtë drejtim, banka do të thellojë investimet e nevojshme në teknologji për të automatizuar dhe ridizajnuar tutje proceset, me qëllim të ngritjes së kualitetit në ofrim të shërbimeve, me efekt të drejtpërdrejtë në ngritjen e kënaqshmërisë së klientëve.

BPB

Banka e vendit tënd

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Që nga themelimi i bankës, përkrah aktiviteteve biznesore, BPB ka për qëllim edhe të jetë pjesë e komunitetit, duke investuar ne ngritjen e cilësisë se jetesës ne komunitetin qe operojmë. Në përputhje me rrethanat, çdo vit, banka ia kushton një pjesë të kohës dhe të parave trajtimit të temave që janë me interes për shoqërinë.

Vitin 2020 e kemi filluar me përkrahje te institucioneve edukative te të gjitha niveleve. Kemi filluar me një kontribut te rëndësishëm për te ndihmuar renovimin e institucionit 'Yllkat', një çerdhe kjo qe është modeluar me standardet evropiane për institucione te tilla. Ne vazhdim, kemi blere libra për shkollën fillore 'Meto Bajraktari' duke pasuruar bibliotekën e kësaj shkolle për nxënësit e saj. Ndërsa, projekti kryesor ka qene donacioni qe kemi bere për te shënuar 50 vjetorin e themelimit te Universitetit te Prishtinës. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" është universiteti i parë publik në Kosovë dhe që pesë dekada edukon dhe përgatit profesionistë për fusha të ndryshme. BPB me krenari ka përkrahur ngjarjen kryesore për te shënuar 50 vjetorin e themelimit të këtij universiteti.

Iniciativat tona për te ndihmuar sistemin e edukimit ne Kosove u ri-konsideruan pas përhapjes se pandemisë ne Kosove, ne muajin mars. Duke pas parasysh qe te gjitha institucionet edukative u mbyllën dhe ne kalonim ne një kohe te pa precedent për vendin, BPB ri-adresoj synimet e saj te përgjegjësisë sociale duke i fokusuar ato ne përkrahjen e bizneseve te vogla dhe institucioneve tjera për te luftuar pandeminë Covid 19.

Fillimisht, kemi organizuar shpërndarjen e dezinfektuesve dhe panove informuese te 500 biznese te vogla me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë dhe ngritjes së vetëdijes së qytetarëve. Kemi vazhduar duke e organizuar dezinfektimin e 50 bizneseve ne gjithë Kosovën, një aktivitet ky qe ka synuar te mbaje lokalet e bizneseve te sigurta dhe te forcoje mesazhin qe BPB është gjithmonë afër bizneseve dhe jo vetëm ne ofrimin e shërbimeve financiare, mirëpo edhe me projekte praktike qe ndihmojnë bizneset ne kohërat me te vështira.

Ne dëshirën tone per te ndihmuar sa me shume institucione, ne përveç aktiviteteve te lartpërmendura për bizneset, kemi ndihmuar edhe institucione si Qendra e Mjekësisë Familjare dhe SOS fshatrat. Ne Qendrën e Mjekësisë Familjare kemi dërguar 65 pulsoksimetra. Këto pajisje mjekësore shërbejnë për matjen e nivelit të oksigjenit dhe matjen e pulsit aktual të zemrës, që janë indikator të rëndësishëm në identifikimin e hershëm të simptomave tek pacientët e prekur nga virusi COVID 19. Ndërsa për SOS fshatrat kemi dhuruar pako ushqimore dhe dezinfektues për t'ia lehtësuar kësaj organizate mbështetjen dhe kujdesin e duhur për banorët të saj në këtë periudhë të vështirë, kur kujdesi për fëmijët është edhe më i nevojshëm.

Ne fund, por jo me më pak rëndësi, BPB mbeti e përkushtuar sportit kosovar. Në vitin 2020 ne sponsorizuam dy ekipe basketbolli, KB Ylli dhe KB Prishtina. Duke pasur parasysh vështirësitë që kanë hasur të gjitha sportet gjatë një viti shumë sfidues, ne kemi dashur të theksojmë mesazhin se BPB është një partner edhe në kohërat më sfiduese. Të dy ekipet, fal edhe ndihmës sonë, kanë arritur të mbajnë një lloj normaliteti në atë që ishte një vit shumë jonormal për të gjithë ne.

BPB
Banka e vendit tënd

RAPORTI VJETOR 2020

BPB

Banka e vendit tënd

BANKA PËR BIZNES SH.A.

RAPORTI I PAVARUR I AUDITORIT DHE PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2020

BPB
Banka e vendit tënd

RAPORTI
VJETOR
2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Deklarata e Përgjegjësisë së Menaxhmentit	1
Raporti i auditorit të pavarur	2
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e pozicionit financiar	7
Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet	8
Pasqyra e rrjedhës së parasë	9
Shënime për pasqyrat financiare	10 - 97

BPB

Deklarata e Përgjegjësive të Menaxhmentit

Drejtuar Aksionarëve dhe Bordit të Banka për Biznes Sh.A.

Ne kemi përgatitur pasqyrat financiare të vitit 2020 me datën që përfundon me 31 Dhjetor 2020, që parqet në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektët material pozicionin financiar të Banka për Biznes Sh.A ("Banka") të datës 31 Dhjetor 2020 dhe rezultatet e operacioneve dhe të rrjedhjes së parave për po këtë vit.

Menaxhmenti është përgjegjës që të sigurojë që Banka mban regjistra kontabël në përputhje me rregulloret bankare të Kosovës dhe të shpalos pozicionet financiare të bankës si dhe rezultatet e aktiviteteve dhe rrjedhjës së parasë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar që përfshin Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Interpretimet të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) dhe Komiteti Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (IFRIC) të IASB dhe që është releavante dhe efektive për aktivitetet e ndërlidhura me periudhat e kontabël.

Menaxhmenti poashtu ka përgjegjësi të gjithanshme për të ndërmarrë hapa të arsyeshëm mbi sigurimin e pasurive të Bankës, të identifikoje dhe parandalojë mashtrime dhe parregullësi të mundshme.

Menaxhmenti konsideron që, në përpunimin e pasqyrave financiare, Banka ka zbatuar Politikat e duhura të Kontabilitetit të aplikuara me gjykime dhe vlerësime të matura të pasuara nga Standardet Internacionale të Raportimit Financiar.

Pasqyrat Financiare janë aprovuar në emër të Menaxhmentit Ekzekutiv.

Prishtinë, Kosovë

Mars 26, 2021

Menaxhmenti Ekzekutiv

BDO

Tel: +381 38 600 031
Fax: +381 38 600 032
www.bdokosovo.com

BDO Kosova L.L.C.
Rr. Ukshin Hoti C4/3, Hy. A, Kati II
10000 Prishtina Kosova

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarët e Banka për Biznes Sh.a.

Raporti mbi auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Banka për Biznes Sh.a. ("Banka"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2020, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Bankës paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Bankës më 31 Dhjetor 2020, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Cështjet kryesore
Çështjet kryesore të auditimit janë ato që ishin, sipas gjykimit tonë profesional, të rëndësisë më të madhe për auditimin tonë të pasqyrave financiare vjetore të ndara dhe të konsoliduara të periudhës aktuale dhe përfshijnë rreziqet më të larta të njohura të keqdeklarimit si rezultat i gabimit ose mashtrimit me ndikimin më të madh në strategjinë tonë të auditimit, shpërndarjen e burimeve tona në dispozicion dhe kohën e kaluar nga ekipi i angazhuar i auditimit. Ne I kemi trajtuar këto çështje në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave vjetore financiare të ndara dhe të konsoliduara si një tërësi në formimin e opinionit tonë për to, dhe ne nuk japim një mendim të veçantë për këto çështje.

Ne kemi përcaktuar që çështjet vijuese ishin çështje kryesore të auditimit dhe duhet të botohen në raportin tonë të Auditorit të Pavarur

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Bankën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

BDO Kosova L.L.C. is a member of BDO International Limited, a UK company limited by guarantee, and forms part of the international BDO network of independent member firms.
BDO is the brand name for the BDO network and for each of the BDO Member Firms

BDO

Provizionet për humbjet e pritura të kredisë për huatë dhe të arkëtueshmet nga klientë	
Më 31 dhjetor 2020 në pasqyrat financiare të bankes kreditë dhe paradhenjet bruto për klientet arrijnë shumën 199,983 mijë euro provizionimi i lidhur me kreditë arrin në 7,327 mijë Euro dhe humbja nga provizionimi njihet në pasqyrën e të ardhurave në vlerën 3,042 mijë Euro (31 Dhjetor 2019: huatë dhe paradhëniet bruto: 187,465 mijë Euro, provizionimi: 5,301 mijë Euro, humbja nga provizionimi e njohur në pasqyrën e të ardhurave: 692 mijë Euro).	
Ceshtjet kryesore të auditimit	Si i adresuam ceshtjet kryesore te auditimit
Ne u përqendruam në këtë fushë për shkak të rëndësisë së shumave të përfshira për pasqyrat financiare të Bankës dhe gjithashtu për shkak të natyrës së gjykimeve dhe supozimeve që kërkohet të bëjë menaxhmenti. Rreziku i kredisë përfaqëson një nga llojet më të rëndësishëm të rreziqeve financiare ndaj të cilave Banka ekspozohet. Përcaktimi i metodave dhe modeleve të përshtatshme nga Menaxhmenti për të matur dhe menaxhuar rrezikun e kredisë është, pra, një nga fushat më të rëndësishme në ruajtjen e kapitalit të Bankës. Si pjesë e procesit të menaxhimit të rrezikut të kredisë, përcaktimet e duhura të provizionimit për humbjet e pritshme të kredisë për huatë dhe të arkëtueshmet nga klientët paraqesin ceshtjet kryesore për menaxhmentin. SNRF kërkon që menaxhmenti të gjykojë në lidhje me të ardhmen dhe zëra të ndryshëm në pasqyrat financiare të Bankës që janë subjekt i pasigurisë së vlerësimit.Vlerësimet e kërkuara për provizionimin e humbjeve të kredisë për kreditë dhe paradhëniet ndaj klientit janë parametra të rëndësishme. Ceshtjet kryesore të gjykimit që lidhen me provizionimin e humbjeve të kredisë për kreditë dhe paradhëniet ndaj klientit janë si më poshtë: • identifikimin e kredive që janë duke u përkeqësuar, • vlerësimi i rritjes së konsiderueshme të rrezikut të kredisë, • parashikimet e flukseve të ardhshme të parave, • të ardhurat e pritshme nga realizimi i kolateralit, • përcaktimi i humbjeve të pritshme të kredive dhe paradhënieve ndaj klientit të cilat janë të gjitha në vetvete të pasigurta Provizionimi matet si humbje e pritshme e kredisë 12 mujore ose si humbje e pritshme e kredisë gjatë gjithë jetës, varësisht prej faktit nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare. Për kreditë e papaguara që konsiderohen të jenë individualisht të rëndësishme ose ekspozime jo performuese të korporatave që arrijne në 422 mijë Euro individualisht, vlerësimi i provizionimit bazohet në njohuritë e secilit huamarrës dhe shpesh në vlerësimin e vlerës së drejtë të kolateralit përkatës. Provizionet përkatese përcaktohen mbi baza individuale me anë të një analize të flukseve të parave të zbritura.	Në mënyrë që të adresojmë rreziqet që lidhen me provizionimin për humbjet e pritshme të kredisë në hua dhe të arkëtueshme nga klientët, të identifikuar si çështje kryesore e auditimit, ne kemi hartuar procedura të auditimit që na lejuan të marrim prova të mjaftueshme të përshtatshme për të perfunduar auditimin tonë. Procedurat tona të auditimit në këtë fushë përfshinin, ndër të tjera: • Rishikimi i metodologjisë së Bankës për njohjen e provizioneve për humbjet e pritura të kredisë dhe krahasimi i metodologjisë së rishikuar kundrejt kërkesave të SNRF 9 instrumentet financiare brenda kornizës së raportimit ligjor • marrja e një kuptimi të procesit të sigurisë, aplikacionet e TI-së të përdorura në të, si dhe burimet kryesore të të dhënave dhe supozimet për të dhënat e përdorura në modelin e pritur të humbjes së kredisë, • vlerësimin dhe testimin e mjedisit të kontrollit të TI-së për sigurinë dhe aksesin e të dhënave. • vlerësimin e dizajnit, zbatimit, efektivitetit operacional të kontrolleve në menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe proceset e huadhënies, testimin e kontrolleve kryesore në lidhje me miratimin, regjistrimin dhe monitorimin e kredive dhe paradhënieve, • testimi i dizajnit, implementimit dhe efektivitetit operacional të kontrolleve kryesore të zgjedhura në fushat e vlerësimit të klientit, si dhe kontrollet në lidhje me identifikimin e ngjarjeve të humbjes dhe parazgjedhjen, përshtatshmëria e klasifikimit të ekspozimeve ndërmjet performancës dhe joperformancës dhe ndarja e tyre në grupe homogjene, llogaritja e ditëve të kaluara pas afatit, vlerësimet e kolateralit dhe llogaritja e provizionimit, • testimi, në bazë të mostrës, nëse përkufizimi i parazgjedhur dhe kriteret e fazës janë zbatuar vazhdimisht në përputhje me politikat përkatëse, • vlerësimi i casjes së përgjithshme të modelimit të llogaritjes së humbjeve të pritshme të kredisë (HPK), duke përfshirë llogaritjen e parametrave kryesorë të rrezikut dhe faktorëve makroekonomikë (probabiliteti i mospagimit (PM), humbja lidhur me mospagimin (LGD) dhe ekspozimi në mospagim (EAD) • testimi i adekuat i provizioneve individuale të humbjeve të kredive, mbi një bazë të mostrës,

BDO

Provizionet për humbjet e pritura të kredisë për huatë dhe të arkëtueshmet nga klientë	
Provizionet ndaj ekspozimeve në retail si dhe ekspozimet e korporatave me probleme nën 422 mijë Euro individualisht (së bashku "lejimi kolektiv i provizionimit") përcaktohen nga teknikat e modelimit. Përvoja historike, identifikimi i ekspozimeve me një përkeqësim të ndjeshëm të cilësisë së kredisë, informacioni i ardhshëm dhe gjykimi i menaxhimit janë përfshirë në supozimet e modelit. Banka po rikalibron në mënyrë të vazhdueshme parametrat e modelit i cili gjithashtu kërkon vëmendjen tonë të shtuar në auditim. Meqenëse përcaktimi i provizionimeve të duhura të zhvlerësimit për humbjet e pritshme të kredisë në kreditë dhe të arkëtueshme kërkon përdorimin e modeleve komplekse (përgjithësisht të varura nga elementet e TI) dhe gjykim të rëndësishëm nga Menaxhmenti, procesi i matjes së humbjeve të pritura të kredisë mund të jetë i ekspozuar ndaj anësisë së menaxhmentit. Prej percaktimit të provizionimit adekuat të humbjeve të pritshtme të kredive në kredi dhe të arkëtueshme kerkon perdorimin e modeleve komplekse (në pergjithsi të varura në elemente të TI) dhe gjykim të rëndësishëm nga menaxhmenti,procesi i matjes së humbjeve të pritshme të kredive mund të jetë i ekspozuar ndaj anësisë së menaxhmentit	me fokus në ato me ndikimin më të madh të mundshëm në pasqyrat financiare për shkak të madhësisë dhe karakteristikave të tyre të rrezikut, si dhe zërave me vlerë më të ulët, të cilët ne i vlerësuam në mënyrë të pavarur si me rrezik të lartë, • kryerjen e testeve dëshmuese në bazë të mostrës së zgjedhur për të vlerësuar korrektësinë e klasifikimit të kredisë. • testimi mbi bazën e madhësisë së informacionit hyrës të përdorur në procesin e provizionimit, saktësia e llogaritjeve nga aplikacionet e TI-së dhe nxjerrja e informacionit nga procesi i provizionimit për qëndrueshmëri dhe saktësi matematikore. • në raste të caktuara, ne përdorëm gjykimin tonë për të përcaktuar parametrat për llogaritjen e humbjeve nga provizionimi i kredive dhe krahasuam llogaritjet tona me provizionimin e vlerës së llogaritur nga Banka, • vlerësimi kritik i ndikimit të pandemisë COVID 19 në lejimet e provizionimit për humbjet e pritshme të kredisë dhe vlerësimi i kornizës rregullatore lokale të ndikuar nga pandemia COVID 19, • vlerësimin e saktësisë dhe tërësisë së shpalosjeve në pasqyra financiare.

Informacione të tjera në Raportin Vjetor

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informata tjetër përmban informacionin e përfshirë në Raportin Vjetor por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin e auditorit tonë të Pavarur mbi to.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe, përveç nëse shprehet ndryshe në raportin tonë, ne nuk shprehim asnjë lloj përfundimi sigurie lidhur me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër dhe, duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose me njohuritë tona të marra në auditim, ose nëse paraqitet të jetë keq deklaruar materialisht. Nëse, bazuar në punën që kemi kryer, konkludojmë se ekziston një keqdeklarim material i këtij informacioni tjetër, ne na kërkohet të raportojmë atë fakt. Në këtë kuptim, ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të ngarkuarve me qeverisje për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, kështu që, një kontroll i brendshëm siç e përcakton menaxhmenti është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime nga keqdeklarimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar tutje, duke shpalosur, siç është e zbatueshme, çështjet në lidhje me shqetësimin e vazhdueshmërisë së bankës dhe duke përdorur bazën e vazhdueshme të kontabilitetit, përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Bankën ose të pushojë aktivitetin, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër realistike, veç se ta bëjë këtë. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

BDO

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimin të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Bankës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërin e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit te vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmentit, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që Banka të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

BDO
BDO Kosova L.L.C
audit, accounting and financial advisory
Prishtina,Kosova

Amir Dermala,
Partner i angazhimit
BDO Kosova L.L.C.
26 Mars 2021
Prishtinë, Kosovë

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

Në mijë Euro	Shënimet	2020	2019
Të ardhurat nga interesi	5	15,589	14,821
Shpenzimet e interesit	5	(2,287)	(2,399)
Të ardhurat neto nga interesi		**13,302**	**12,422**
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	6	3,524	3,037
Shpenzimet për tarifat dhe komisionet	6	(1,190)	(1,047)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet		**2,334**	**1,990**
Kthimi nga kreditë e shlyera		475	502
Fitimi neto nga këmbimi valutor		39	63
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë	13	510	1,003
Gjithsej të ardhurat operative		**16,660**	**15,980**
Të ardhurat tjera	7	163	224
Shpenzimet e humbjes kreditore dhe paradhëniet për klientë	14	(3,042)	(692)
Shpenzimet e humbjes kreditore për pasuritë financiare	10-13	(20)	(15)
Rënia e vlerës së pasurive të riposeduara	18	(161)	(61)
Provizionet tjera		(129)	(25)
Shpenzimet tjera operative	8	(8,412)	(8,379)
Fitimi para tatimit ne fitim		**5,059**	**7,032**
Shpenzimet e tatimit në fitim	9	(530)	(693)
Fitimi neto per vitin		**4,529**	**6,339**
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
Zërat që nuk klasifikohen në fitim ose humbje			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare me vlerë të drejtë përmes humbjeve të tjera gjithëpërfshirëse		(26)	(15)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		**4,503**	**6,324**
Fitimi për aksion (në mijë Euro)	23	**0.16**	**0.22**

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 27 janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2020

Në mijë Euro	Shënimet	2020	2019
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	10	25,082	21,600
Gjendja në Bankën Qendrore të Kosovës	11	52,465	42,031
Plasmanet dhe balancat në banka	12	5,261	6,053
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ATGJ	13	53,535	38,646
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	14	192,656	182,164
Pasuritë tjera financiare	15	272	206
Pasuritë e paprekshme	16	605	515
Prona dhe pajisjet	17	2,318	2,850
E drejta e përdorimit të pasurive	22	2,553	2,843
Pasuritë tjera	18	151	203
Gjithsej Pasuritë		**334,898**	**297,111**
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	19	288,883	253,955
Kreditë e varura	20	502	502
Huamarrjet	20	4,074	6,334
Detyrimet ndaj qirase	22	2,612	2,825
Provizione	21	511	539
Detyrimet për tatimin e shtyrë	9	20	74
Detyrimet tjera	21	2,689	1,778
Gjithsej detyrimet		**299,291**	**266,007**
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	23	11,247	11,247
Rezervat tjera të kapitalit	23	769	857
Rezerva e rivlerësimit	23	96	96
Rezerva për vlerën e drejtë		(93)	(67)
Fitimi i akumuluar		23,588	18,971
Gjithsej ekuiteti		**35,607**	**31,104**
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		**334,898**	**297,111**

Këto Pasqyra Financiare janë miratuar nga menaxhmenti i Bankës me 26 Mars 2021 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Arton Celina
Kryeshef Ekzekutiv

Avni Berisha
Udhëheqës i Departamentit të Financave

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 27 janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

	Kapitali aksionar	Rezervat tjera të kapitalit	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i mbajtur	Gjithsej
Në mijë Euro						
Gjendja më 1 Janar 2019	11,247	857	96	(52)	13,631	25,779
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	6,339	6,339
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse						
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare përmes humbjeve të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	(15)	-	(15)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	-	-	(15)	6,339	6,324
Transaksionet me mbajtësit e kapitalit						
Shpërndarja e dividentit	-	-	-	-	(999)	(999)
Gjendja me 31 Dhjetor 2020	11,247	857	96	(67)	18,971	31,104
Gjendja më 1 Janar 2020	11,247	857	96	(67)	18,971	31,104
Rregullimi i rezervave per barazim me raportimin e BQK-se dhe SNRF-ve	-	(88)	-	-	88	-
Gjendja më 1 Janar 2020 rregulluar	11,247	769	96	(67)	19,059	31,104
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	4,529	4,529
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse						
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare përmes humbjeve të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	(26)	-	(26)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	-	-	(26)	4,529	4,503
Gjendja me 31 Dhjetor 2020	11,247	769	96	(93)	23,588	35,607

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 27 janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

Në mijë Euro	Note	2020	2019
Rrjedhja e Parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit para tatimit		5,059	7,032
Rregulluar për:			
Amortizimi	16	225	237
Zhvlerësimi	17	753	755
Efekti i tranzicionit të rregullimit në SNRF 9		(857)	-
Fitimi nga shitja e pronave, pajisjeve dhe pasurive te riposeduara		(1)	(7)
Fitimi nga kolaterali i riposeduar		(110)	(188)
Humbjet nga provizioni i kredive	14	3,042	692
Humbjet nga rënia në vlerë e pasurive financiare		20	(15)
Rënia në vlerë për pasuritë e riposeduara	18.1	161	61
Privizionet tjera		129	25
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		(510)	(1,003)
Shpenzimet e interesit	5	2,287	2,399
Të ardhurat nga interesi	5	(15,589)	(14,821)
		(5,391)	(4,833)
Ndryshimet në:			
Kreditë dhe paradhëniet për banka	12	792	(1,270)
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	14	(12,240)	(24,162)
Rezerva e detyrushme në BQK	11	(4,017)	(2,937)
Pasuritë tjera	18	21	239
Pasuritë tjera financiare	15	(66)	172
Depozitat nga klientët	19	34,788	32,449
Detyrimet dhe provizionet tjera		651	436
Paraja e gjeneruar nga aktiviteti operativ		14,538	94
Interesi i arkëtuar		15,618	14,697
Interesi i paguar		(2,121)	(1,946)
Tatimi në fitim i paguar	9	(570)	(754)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		27,465	12,091
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Investimet në letra me vlerë të mbajtuara për shitje		(14,901)	(8,514)
Blerja e pronave dhe pajisjeve	16	(315)	(350)
Blerja e pasurive të paprekshme	17	(217)	(828)
Të hyrat nga shitja e pasurive të riposeduara		110	188
Të hyrat nga shitja e pronave dhe pajisjeve		-	77
Rrjedhja neto e gjeneruar nga aktivitetet investuese		(15,323)	(9,427)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagesa e huamarrjeve	20	(2,486)	(2,873)
Inkasimet nga huamarrjet	20	253	4,080
Dividenda e shpërndarë		-	(999)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		(2,233)	208
Rritja neto e parasë dhe ekuivalenetëve të saj		9,909	2,872
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim te vitit	10	43,012	40,140
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	10	52,921	43,012

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 27 janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare
Për vitin qe ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020
(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

1. HYRJE

Banka për Biznes Sh.a.e njohur më parë si Banka Private e Biznesit Sh.a. ka marrë licencën për aktivitete bankare me 29 mars 2001 dhe ka filluar operimin me 24 prill 2001. Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve më 28 shkurt 2005 dhe pas miratimit final nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK") më datë 22 mars 2005, Banka ka ndryshuar emrin nga Banka Private e Biznesit në Banka për Biznes ("Banka"). Në vitin 2006, Banka është regjistruar si shoqëri aksionare ("Sh.a"). Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e konsumatorëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve dhe 19 nën degëve të saj të vendosura në tërë Kosovën (2019: 7 degëve dhe 19 nën degë).

Pasqyarat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 ishin autorizuar për t'u lëshuar në pajtim me vëndimin e drejtorëve më 26 Mars 2021.

2. BAZAT E PËRGADITJES

2.1 Bazat e Kontabilitetit

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).
Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç pasqyrave financiare të listuara më poshtë, të cilat janë matur me vlerën e drejtë:

- Instrumentet e borxhit të mbajtura nën modelin e biznesit të mbajtur për mbledhje dhe shitje.

Ndryshimet në lidhje me politikat e rëndësishme të kontabilitetit përshkuhen në Shënimin nr.3.

2.2 Bazat e matjes

Këto pasqyra finaciare janë përgatitur mbi bazen e vlerës së drejtë për pasuritë dhe detyrimet financiare më vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, pasuritë financiare të matura me vlerën e drejtë përmes te ardhurave tjera gjithëpërfshirëse dhe investimet ne prone. Pasuritë dhe detyrimet tjera financiare, dhe pasuritë dhe detyrimet tjera jofinanciare, janë deklaruar me koston e amortizuar ose historike.

2.3 Standardet e reja dhe të ndryshuara dhe interpretimi i tyre

2.3.1 Standardet efektive, ndryshimet në standarde dhe zbatimet në vitin 2020

Me përjashtim të ndryshimeve më poshtë, Banka ka zbatuar vazhdimisht politikat e kontabilitetit të përcaktuara në Shënimet më poshtë për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Në vitin 2020, standardet e mëposhtme, ndryshimet ose interpretimet qe hynë në fuqi:
- Ndryshimet në Referencat e Kornizës konceptuale në Standardet e SNRF-ve;
- Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8: Përkufizimi i materialit;
- Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 17: Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit;
- Ndryshimet në SNRF 3: Kombinimet e Biznesit;
- Ndryshimi në SNRF 16: Objektet me qira të lidhura me COVID-19.

Këto ndryshime u sigurojnë qiramarrësve një përjashtim (të lejuar dhe jo të kërkuar) nga vlerësimi nëse një koncesion qiraje i lidhur me COVID-19 është një modifikim i qirasë. Njësitë ekonomike që zbatojnë përjashtimin, të disponueshme nga 1 qershori 2020, do të llogaritnin ndryshimet sikur të mos ishin modifikime të qirasë.
- Banka nuk ka zbatuar përjashtimin e parashikuar nga ndryshimet e SNRF 16 Adaptimi i këtyre standardeve nuk ka përcaktuar efekte thelbësore në shumat e njohura në bilancin e gjendjes ose pasqyrën e të ardhurave.

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.3 Standardet e reja dhe te ndryshuara dhe interpretimi i tyre (vazhdim)

2.3.2 Standardet, ndryshimet në standarde dhe interpretimet e lëshuara por që nuk janë ende efektive

Standardet, ndryshimet në standarde dhe interpretimet që janë lëshuar, por që nuk janë ende efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare janë shpalosur më poshtë. Banka synon të adaptoj këto standarde, nëse janë të zbatueshme, kur ato të bëhen efektive.

Më 31 dhjetor 2020, Komisioni Evropian miratoi ndryshimet e mëposhtme në parimet e Kontabilitetit të zbatueshme për raportimin, të cilat hynë në fuqi më ose pas 1 Janarit 2021:

- Ndryshimet në SNRF 4: Kontratat e Sigurimit - shtyrja e SNRF 19
- Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit - Faza 2 (Gusht 2020)

Më 31 dhjetor 2020, IASB lëshoi standardet, ndryshimet, interpretimet ose rishikimet e mëposhtme, aplikimi i të cilave i nënshtrohet përfundimit të procesit të miratimit nga organet kompetente të Komisionit Evropian, i cili është ende në vazhdim:

- SNRF17 Kontratat e Sigurimit (maj 2017) përfshirë ndryshimet në SNRF 17: Kontratat e Sigurimit (Qershor 2020);
- Ndryshimet në SNK 1: Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Pasurive si afatshkurter dhe afatgjate dhe Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkurter dhe afatgjata - Shtyrja e datës së hyrjes në fuqi (janar 2020 dhe 15 korrik 2020, përkatësisht)
- Ndryshimet në SNRF3: Kombinimet biznesore (Maj 2020);
- Ndryshimet në SNK 16: Prona, Impiantet dhe Pajisjet (Maj 2020);
- Ndryshimet në SNK 37 Provizionet, Detyrimet kontigjente dhe Pasuritë kontigjente (Maj 2020);
- Ndryshimet në përmirësimet vjetore 2018-2020 (Maj 2020).

Këto standarde nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Bankës.

2.4 Monedha funksionale dhe prezantuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në EUR, e cila është monedha funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijërat më të afërt, përveç kur tregohet ndryshe.

2.5 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave të kontabilitetit të Bankës dhe shumat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet në vlerësime njihen në mënyrë të mundshme.

Informacioni në lidhje me fushat domethënëse të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave të kontabilitetit që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet 3, 4 dhe 25.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në menyrë konsistente në te gjitha përiudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

a) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Sipas SNRF 9 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. "Norma efektive e interesit" është ajo normë që diskonton saktësisht pagesa të ardhshme të parave të gatshme ose arkëtimet gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar (ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër) për:

- vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhat e ardhshme të parasë duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar por jo humbjet e ardhshme kreditore. Për pasuritë financiare të rëna në vlerë, një normë efektive e interesit të rregulluar nga kredia llogaritet duke përdorur rrjedhat e ardhshme të vlerësuara të parasë duke përfshirë humbjet e pritshme kreditore

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshinë të gjitha kostot e transaksionit të tarifave dhe komisionet dhe zbritjet e tjera të paguara ose pranuara, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo emetimin e një pasurie apo detyrimi financiar.

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit zbatohet në vlerën kontabël bruto të pasurive (kur pasuritë nuk janë të rëna në vlerë) ose në koston e amortizuar të detyrimit.

Sidoqoftë, sipas SNRF 9 për pasuritë financiare që kanë pasur rënie në vlerën kreditore pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të pasurisë financiare. Nëse pasuria nuk është më e rënë në vlerën kreditore, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi rikthehet në bazë bruto.

Sipas SNRF 9 për pasuritë financiare të cilat kanë rënë në vlerën kreditore në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit të rregulluar nga kredia në koston e amortizuar të pasurisë. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në baza bruto, edhe nëse risku kreditor i pasurisë përmirësohet.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) përfshijnë:

- interesin nga pasuritë dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv; dhe interesi nga instrumentet e borxhit të matur në VDATGJ të llogaritura mbi bazën interesit efektiv.

b) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një pasuri ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.
Sipas SNRF 15, Banka fiton të ardhura nga tarifat dhe komisionet nga një gamë e larmishme e shërbimeve financiare që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në një shumë që reflekton konsideratën në të cilën Banka pret të ketë të drejtë në këmbim të ofrimit të shërbimeve.Detyrimet e performancës, si dhe kohëzgjatja e plotësimit të tyre, identifikohen dhe përcaktohen në fillim të kontratës. Kontratat e të ardhurave të Bankës zakonisht nuk përfshijnë detyrime të shumta të performances

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

b) Tarifat dhe komisionet (vazhdim)

Shërbimet që Banka ofron për klientët e saj, duhet të paguhen menjëherë pas përmbushjes së një shërbimi në një moment të caktuar.Banka në përgjithësi ka konkluduar se janë thelbësore kontratat e saj të të ardhurave sepse zakonisht i kontrollon shërbimet përpara se t'i transferojë ato tek klienti.
Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.
Një kontratë me një klient që rezulton në një instrument financiar të njohur në pasqyrat financiare të Bankës mund të jetë pjesërisht në fushën e SNRF 9 dhe pjesërisht në fushën e SNRF 15. Nëse ky është rasti, atëherë Banka së pari zbaton SNRF 9 për tu ndarë dhe mat pjesën e kontratës që është në fushën e SNRF 9 dhe më pas zbaton SNRF 15 për pjesën e mbetur.

c) Qiratë

Në fillimin e një kontrate, Banka vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të vlerësimit.

Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura (ose ndryshuar) në ose pas 1 janarit 2019.

Në fillim ose në modifikimin e një kontrate që përmban një komponent qiraje, Banka cakton konsideratë në kontratë për secilin komponent të qirasë në bazë të çmimit të saj relativ të pavarur. Sidoqoftë, për qiradhëniet e degëve dhe ambienteve të zyrave, Banka ka zgjedhur që të mos ndajë përbërësit jo-qira dhe llogaritë për përbërësit e qirasë dhe jo-qirasë si një përbërës i vetëm i qirasë.

Banka njeh një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim të qirasë në datën e fillimit të qirasë. E drejta e përdorimit të pasurisë fillimisht matet me kosto, i cili përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë rregulluar për çdo pagesë qiraje të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte të kryer dhe një vlerësim të kostove për të demoluar dhe hequr çdo përmirësim i bërë në degë ose ambiente zyre.

E drejta e përdorimit të pasurisë zhvlerësohet më pas duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fund të afatit të qirasë. Për më tepër, e drejta e përdorimit të pasurisë reduktohet në mënyrë periodike nga humbjet e zhvlerësimit, nëse ka, dhe rregullohet për disa matje të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, zbriten duke përdorur normën inkrementale të interesit në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, norma rritëse e huamarrjes së Bankës. Në përgjithësi, Banka përdor normën e saj të huamarrjes si normë skontimi.

Banka përcakton normën e saj të huamarrjes duke analizuar huazimet e saj nga burime të ndryshme të jashtme dhe bën rregullime të caktuara për të pasqyruar kushtet e qirasë dhe llojin e pasurisë të marrë me qira. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e pasivit të qirasë përfshijnë sa vijon:

- pagesa fikse, përfshirë pagesat fikse në thelb;
- pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit;
- shumat që pritet të paguhen nën një garanci të vlerës së mbetur; dhe
- çmimi i ushtrimit nën një opsion blerjeje që Banka është e arsyeshme e sigurt për të ushtruar, pagesa me qira në një periudhë opsionale rinovimi nëse Banka është e sigurt se do të ushtrojë një mundësi zgjatjeje dhe gjobat për përfundimin e parakohshëm të një qiraje përveç nëse Banka është e arsyeshme e sigurt të mos përfundojë në fillim të vitit 2020.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

c) Qiratë (vazhdim)

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Ajo ri-vlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Bankës të shumës që pritet të paguhet nën një garancion të vlerës së mbetur, nëse Banka ndryshon vlerësimin e saj nëse do të ushtrojë një mundësi blerjeje, zgjatjeje, përfundimi ose nëse ka një pagesë fikse të rishikuar të qirasë.

Kur detyrimi i qirasë ri-vlerësohet në këtë mënyrë, një rregullim përkatës bëhet në vlerën kontabël të së drejtës së përdorimit të pasurisë, ose regjistrohet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e së drejtës së përdorimit të pasurisë është zvogëluar në zero.

Banka paraqet të drejtën e përdorimit të pasurive dhe detyrimet e qirasë në Shënimin 22 dhe veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar.

Qiratë afatshkurtra dhe qiratë e pasurive me vlerë të ulët

Banka ka zgjedhur të mos njohë të drejtën e përdorimit të pasurive dhe detyrimeve të qirave për qiratë me vlerë të ulët dhe afatshkurtra, duke përfshirë qiranë e pajisjeve të IT-së. Banka njeh pagesat e qirasë të shoqëruara me këto qira si një shpenzim mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

d) Shpenzimet e tatimit

Tatimi aktual përfshinë tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat ose humbjet e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

Pasuritë dhe detyrimet aktuale tatimore kompensohen vetëm nëse përmbushen disa kritere të caktuara.

(i) Tatimi aktual

Current tax is the expected tax payable or receivable on the taxable income or loss for the year, using tax rates enacted or substantively enacted at the reporting date, and any adjustment to tax payable in respect of previous years.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme qe dalin midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve në pasqyra financiare. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin me rastin e njohjes fillestare të pasurive ose detyrimeve të transaksioneve që nuk përbëjnë një kombinim biznesi dhe që nuk ndikojnë as në fitimin, as në humbjen kontabël dhe as në atë të tatueshme.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do ta përcjellin mënyrën në të cilën Banka pret në fund të periudhës raportuese që të mbulojë apo vendosë vlerën kontabël të mjeteve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë matet sipas normave tatimore që priten të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato kthehen, përmes normave tatimore në fuqi në datën e raportimit.
Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen ndërmjet tyre nëse ka një të drejtë ligjore për ta kompensuar me mjetin dhe detyrimin e tatimit dhe kur ndërlidhen me tatimet e pagueshme kundrejt autoritetit të njëjtë tatimor.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d) Shpenzimet e tatimit (vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyer (vazhdim)

Tatimet shtesë që vijnë si rezultat i shpërndarjes së dividendës nga ana e Bankës njihen në të njëjtën kohë kur edhe njihen detyrimet për ta paguar dividendën respektive.

Një pasuri tatimore e shtyrë njihet për humbjet sipas tatimeve, kredive tatimore dhe dallimet e përkohshme të zbritshme të pashfrytëzuara, vetëm në atë masë që është e mundur të shfrytëzohet për fitimet e ardhshme të tatueshme kundër të cilave mund të shfrytëzohet kjo pasuri. Pasuritë e tatimit të shtyrë rishikohen në secilën datë të raportimit dhe reduktohen në atë masë që nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me adekuatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

e) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj rivlerësohen në valutën funksionale përkatëse të Bankës me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit të asaj date.

Fitimi ose humbja nga zërat monetar është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutë funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës si dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj me kursin e këmbimit në fundin e vitit. Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në valutë të huaj që maten me vlerën e drejtë janë konvertuar në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në valutë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga rivlerësimi njihen në fitim ose humbje.

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Banka fillimisht njehë huatë dhe paradhëniet, depozitat, letrat me vlerë të emetuara të borxhit, huazimet dhe detyrimet e varura në datën në të cilën ato janë origjinuar. Të gjitha instrumentet e tjerë financiarë (përfshirë blerjet në rrugë të rregullt dhe shitjet e pasurive financiare) njihen në datën e tregtisë, që është data në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të këtij instrumenti.Një pasuri ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për një zë jo në VDATGJ, kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të tij. Vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i tij i transaksionit. Shikoni Shënimin f) vii) për një përshkrim të politikës nëse vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit.

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Në njohjen fillestare, një pasuri financiare klasifikohet si e matur me: koston e amortizuar, VDATGJ ose VDPFH.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- pasuritë mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e pasurive për mbledhjen e rrjedhave kontraktuale të parasë; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiar japin datat e përcaktuara në rrjedhat e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguarNjë instrument borxhi matet në VDATGJ vetëm nëse plotëson të dyja këto kushte dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:
- pasuritë mbahen brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e rrjedhat kontraktuale te parasë dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiar japin datat e përcaktuara në rrjedhat e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar

Për njohjen fillestare të një investimi kapital që nuk mbahet për shitje, Banka mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në ATGJ. Kjo zgjedhje bëhen në bazë të investimeve për investime. Të gjitha pasuritë financiare të bankës klasifikohen si të matura me koston e amortizuar ose në VDATGJ.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Banka bën një vlerësim të objektivit të një modeli biznesi në të cilin një pasuri është mbajtur në një nivel të portofolit, sepse kjo më së miri reflekton mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe i jepet informacioni menaxhmentit. Informacioni i konsideruar përfshinë:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimin e këtyre politikave në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e menaxhmentit fokusohet në fitimin e të ardhurave nga interesi kontraktual, duke ruajtur një profil të caktuar të normës së interesit, duke përputhur kohëzgjatjen e pasurive financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato pasuri ose realizimin e rrjedhës së parasë nëpërmjet shitjes së pasurive;
- si vlerësohet dhe raportohet performanca e portofolit te menaxhmentin e Bankës;
- risqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe pasuritë financiare të mbajtura brenda modelit të biznesit) dhe si menaxhohen ato risqe;
- se si menaxherët e biznesit janë kompensuar - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të pasurive të administruara ose rrjedhat së parasë kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuenca, vëllimi dhe koha e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për shitjet e tilla dhe pritshmëritë e tij për aktivitetin e ardhshëm të shitjes. Megjithatë, informacioni rreth aktivitetit të shitjeve nuk konsiderohet veç e veç, por si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm se si është arritur objektivi i Bankës për menaxhimin e pasurive financiare dhe si realizohen rrjedha të parasë.

Banka nuk mban ndonjë pasuri financiare që mbahet për tregtim ose menaxhim dhe performanca e të cilave vlerësohet sipas VDPFH.

Vlerësimi nëse rrjedhat kontraktuale të parasë janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit - Për qëllimet e këtij vlerësimi, 'principali' përcaktohet si vlera e drejtë e pasurisë financiare në njohjen fillestare. 'Interesi' përcaktohet si një shpërblim për vlerën kohore të parasë dhe për riskun kreditor që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për risiqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. risku i likuiditetit dhe kostot administrative) si dhe për marzhën e fitimit.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Vlerësimi nëse rrjedhat kontraktuale të parasë janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (vazhdim)

Në vlerësimin nëse rrjedhat kontraktuale të parasë janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, Banka konsideron kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshinë vlerësimin nëse pasuritë financiare përmbajnë një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e rrjedhat kontraktuale të parasë në mënyrë që ajo të mos plotësojë këtë kusht. Gjatë marrjes së vlerësimit, Banka konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që do të ndryshonin sasinë dhe kohën e rrjedhave të parasë ;
- karakteristikat e borxhit;
- parapagimi dhe afatet e zgjatjes;
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Bankës për rrjedhat e parasë nga pasuritë e specifikuara; dhe
- karakteristika që ndryshojnë konsideratën për vlerën kohore të parasë - p.sh., rivendosjen periodike të normave të interesit.

Banka ka një portofol kredie afatgjatë me normë fikse për të cilën Banka ka mundësi të propozojë rishikimin e normës së interesit në datat e rivendosjes periodike. Këto të drejta të rivendosjes janë të kufizuara në normën e tregut në kohën e rishikimit. Huamarrësit kanë një mundësi që të pranojnë normën e rishikuar ose të shlyejnë huanë në parim pa dënim. Banka ka përcaktuar që rrjedhat kontraktuale të parasë të këtyre kredive janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit sepse opsioni ndryshon normën e interesit në një mënyrë që është konsideratë për vlerën kohore të parasë, riskun e kredisë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe kostot që lidhen me shumat kryesore të papaguara

Riklasifikimet

Pasuritë financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën pas ndryshimit të modelit të biznesit të saj për menaxhimin e pasurive financiare.

(iii) Ç'regjistrimi

Pasuritë financiare

Banka çregjistron një pasuri financiare kur mbarojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhjet e parave nga pasuria financiare ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhje të parave kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha risiqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Banka as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për ç'regjistrim që është krijuar apo mbajtur nga Banka njihet si një pasuri ose detyrim në vete.

Banka hyn në transaksione me të cilat transferon pasuritë e njohura në pasqyrën e saj të pozicionit financiar, por ruan të gjitha ose në thelb të gjitha risiqet dhe përfitimet e pasurive të transferuara ose një pjese të tyre. Në raste të tilla, pasuritë e transferuara nuk ç'regjistrohen. Shembuj të transaksioneve të tilla janë huatë e letrave me vlerë dhe transaksionet e shitjes dhe riblerjes.

Kur pasuritë i shiten një pale të tretë me një normë totale të kthimit në pasuritë e transferuara, transaksioni trajtohet si një transaksion financimi i siguruar, i ngjashëm me transaksionet e shitjeve dhe të riblerjes, sepse Banka mban të gjitha ose në thelb të gjitha risqet dhe shpërblimet e pronësisë së këtyre pasurive.

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare
Për vitin qe ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020
(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Ç'regjistrim (vazhdim)

Pasuritë financiare (vazhdim)

Në transaksionet në të cilat Banka nuk ruan ose transferon në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë së një pasurie financiare dhe mban kontrollin mbi pasurinë, Banka vazhdon të njohë pasurinë deri në masën e përfshirjes së saj të vazhdueshme, të përcaktuar sipas masës për të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e pasurisë së transferuar.

Detyrimet Financiare

Banka ç'regjistron një detyrim financiar kur obligimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose kanë përfunduar.

(iv) Modifikimet e pasurive dhe detyrimeve financiare

Pasuritë financiare

Nëse kushtet e një pasurie financiare ndryshohen, Banka vlerëson nëse rrjedhat kontraktuale të parasë të pasurise së modifikuar janë në thelb të ndryshme. Nëse rrjedhat e parasë janë substancialisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale në rrjedhat e parasë nga pasuria financiare fillestare, konsiderohen se kanë skaduar.

Në këtë rast, pasuritë financiare origjinale ç'regjistrohen dhe një pasuri financiare e re njihet me vlerën e drejtë.
Në këtë rast, pasuria fillestare financiare çregjistrohet dhe një pasuri e re financiare njihet me vlerën e drejtë plus çdo kosto të pranueshme të transaksionit. Çdo tarifë e marrë si pjesë e modifikimit llogaritet si më poshtë:

- tarifat që merren parasysh në përcaktimin e vlerës së drejtë të pasurisë së re dhe tarifat që përfaqësojnë rimbursimin e kostove të pranueshme të transaksionit përfshihen në matjen fillestare të pasurisë; dhe
- tarifat e tjera përfshihen në fitim ose humbje si pjesë e fitimit ose humbjes nga çregjistrimi.

Nëse rrjedhat e parasë së pasurisë së modifikuar të bartur me koston e amortizuar nuk janë në thelb të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrimin e pasurisë financiare. Në këtë rast, Banka rikalkulon vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe njeh shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje e modifikuar në fitim ose humbje. Nëse një ndryshim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga rënia në vlerë. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhura nga interesi.

Detyrimet financiare

Banka e çregjistron një detyrim financiar kur kushtet dhe rrjedhja e parasë e atij detyrimi ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast, detyrimi i ri financiar bazohet me kushtet e reja të ndryshuara në vlerën e tij të drejtë. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar që çregjistrohet dhe shumës së paguar njihet si fitim ose humbje. Konsiderata e paguar përfshin pasuritë jo-financiare të transferuara, nëse ka, dhe supozimit të detyrimit, duke përfshirë ndryshim e ri të detyrimit financiar.

Nëse ndryshimi i detyrimit financiar nuk llogaritet si çregjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rikalkulohet duke zvogëluar rrjedhjen e parasë në normën efektive origjinale të interesit dhe shuma e fituar ose e humbur, regjistrohet si fitim ose humbje.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Detyrimet financiare (vazhdim)

Për detyrimet financiare me normë të ndryshueshme, norma efektive origjinale e interesit e përdoruar për të kalkuluar ndryshimet në fitim ose humbje rregullohet ashtu që të reflektojë kushtet aktuale të tregut në kohën e modifikimit. Çdo kosto dhe tarifë e shkaktuar njihet si një rregullim i vlerës kontabël të detyrimit dhe amortizohet gjatë periudhës së mbetur të detyrimit financiar të modifikuar duke rillogaritur normën efektive të interesit në këtë instrument.

(v) Netimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë, dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe te shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, apo për fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup i transaksioneve të ngjashme sikurse nga aktiviteti komercial i bankës.

(vi) Matja me kosto të amortizuar

'Kosto e amortizuar' e një pasurie ose detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, dhe për pasuritë financiare të rregulluara për ndonjë zbritje të pritshme të humbjes nga kreditë."Vlera kontabël bruto e një pasurie financiare' është kostoja e amortizuar e një pasurie financiare përpara se të korrigjohet për çdo zbritje të humbjes së pritshme kreditore.

(vii) Matja me vlerë të drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi me të cilin pasuria mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm ku Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron riskun e mosekzekutimit të tij.

Kur është e mundur, Banka përcakton vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në tregun aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me pasurinë apo detyrimin ndodhin shumë shpesh dhe me volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin.

Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshinë gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të t është zakonisht çmimi i transaksionit –për shembull; vlera e drejtë e konsideratës së dhënë os të marrë. Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një tre aktiv për një pasuri apo detyrim identik, e as nuk është e bazuar në një teknikë vlerësimi q përdor vetëm të dhëna nga tregjet të vrojtueshme në treg, atëherë instrumenti financiar mate fillimisht me vlerën e drejtë, i rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejt në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë është njohur në fitir ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se vlerësim që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Matja me vlerë të drejtë (vazhdim)

Nëse një pasuri ose një detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim oferte dhe një çmim kërkese, atëherë Banka mat pasuritë dhe pozicionet e gjata me një çmim oferte dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me një çmim kërkese.

Vlera e drejtë e një kërkese për depozita nuk është më e vogël se shuma e pagueshme në kërkesë, e zbritur nga data e parë në të cilën shuma mund të kërkohet të paguhet.

Banka njeh transferime midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë që nga fundi i periudhës së raportimit gjatë së cilës ndryshimi ka ndodhur në nivelet e VD (shënimi 4).

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Banka njeh lejimet e humbjes për HPK në instrumentet e mëposhtëm financiare që nuk maten në VDPFH:

- pasuritë financiare që janë instrumente borxhi; dhe
- angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare të lëshuara (më parë, zhvlerësimi ishte matur nën SNK 37 Provizione, Detyrime kontabël dhe aktive të kushtëzuara).

Banka do të njohë provizionet e humbjeve në një shumë të barabartë me HPK-të përgjatë jetës, përveç në rastet e mëposhtme, për të cilat shuma e njohur do të jetë HPK 12-mujore:

- Letra me vlerë të investimeve në borxh që përcaktohet se kanë rrezik të ulët kredie në datën e raportimit. Banka konsideron se një obligacion ka rrezik të ulët kredie kur vlerësimi i rrezikut të kredisë është ekuivalent me përkufizimin e kuptuar globalisht si ''shkallë-investimi ''; dhe
- Kredi dhe letra me vlerë të investimeve të borxhit për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

Matja e HPKs

HPK janë një vlerësim i ponderuar i probabilitetit të humbjeve kreditore dhe do të maten si më poshtë:

- pasuritë financiare që nuk janë të rëna në vlerë në datën e raportimit: vlera aktuale e të gjitha humbjeve në mjete monetare - d.m.th. Diferenca midis rrjedhave të parasë që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe rrjedhat e parasë që Banka pret të marrë;
- pasuritë financiare që janë të rëna në vlerë në datën e raportimit: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të rrjedhave të parasë të ardhshme të vlerësuara;

Skontoni flukseve të ardhshme të parave, përdoren normat e mëposhtme të skontimit:

- *pasuritë financiare të ndryshme nga pasuritë financiare të blera ose të dëmtuara (POCI) dhe të arkëtueshmet e qirasë:* norma origjinale e interesit efektiv ose një vlerë e përafërt e tyre;
- *pasuritë POCI:* një normë interesi efektive e kredive e axhustuar;
  zotimet e kredive të patërhequra: norma efektive e interesit, ose një përafrim i tyre, që do të zbatohet për pasurinë financiare që rezulton nga zotimi i kredisë; dhe
- *kontratat e lëshuara të garancioneve financiare:* norma që pasqyron vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parave dhe rreziqet që janë specifike për flukset e parave.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

- *zotimet e kredive:* vlera aktuale e diferencës ndërmjet rrjedhave kontraktuale të parasë që i detyrohen Bankës nëse tërheqja e zotimit dhe rrjedhat e parasë që Banka pret të marrë; dhe
- *kontratat e garancioneve financiare:* vlera aktuale e pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Banka pret të kthejë

Përkufizimi i vonesave

Sipas SNRF 9, Banka do të konsiderojë një pasuri financiare në vonesë kur:

- huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të kredisë në Bankë në tërësi, pa pasur nevojë nga ana e Bankës për veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- huamarrësi ka më shumë se 90 ditë të kaluara për çdo detyrim material kredie për Bankën.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullatore për kreditë e klasifikuara si të dyshimta ose humbje (shih Shënimin 3 (vii)).

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në vonesë, Banka do të konsiderojë që treguesit janë në përputhje me kërkesat rregullatore të riskut për klasifikimin e huave si të dyshimta ose të humbura:

- cilësore: p.sh. shkeljet e kovenantave kontraktuale;
- sasiore: p.sh. statusi i vonuar dhe mos pagesa e një detyrimi tjetër të të njëjtit huamarrës në Bankë; dhe
- klasifikimi rregullator i riskut të huamarrësve të njëjtë në banka të tjera.

Inputet në vlerësimin nëse një instrument financiar është në vonesë dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të reflektuar ndryshimet.

Vlerësimi i riskut kreditor

Banka vendosë çdo ekspozim në një shkallë të riskut kreditor bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Menaxhimit të Riskut Kreditor, duke përdorur faktorë cilësor dhe sasior që janë tregues të rrezikut të mospagimit. Përveç klasave të rrezikut të paraqitura për qëllime rregullatore, Banka identifikon dhe monitoron veçmas kreditë standarde në vonesë nga kreditë standarde jo në vonesë. Çdo ekspozim do të alokohet në një shkallë të riskut kreditor në njohjen fillestare bazuar në informacionin e disponueshëm në lidhje me huamarrësit. Ekspozimet do t'i nënshtrohen një monitorimi të vazhdueshëm, i cili mund të rezultojë në një ekspozim të zhvendosur në një shkallë të ndryshme të riskut kreditor.

Rritja e konsiderueshme në riskun kreditor

Rritja e ndjeshme e riskut të vonesave dhe vonesat vet janë janë përcaktuesit kryesorë për llogaritjen e humbjeve të pritura të kredisë.
Në secilën datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të riskut të kreitor duke krahasuar: (i) riskun që kredia do të jetë ne vonese ne daten e raportimit ose pas datës së raportimit (ii) riskun e vonesave të vlerësuar në ose pas data e njohjes fillestare të saj.
Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Banka konsideron informacion të parashikuar dhe historik të arsyeshëm dhe të mbështetur për hua individuale, ose grup kredish kur informacioni i arsyeshëm dhe i përkrahshëm nuk është i disponueshëm në baza individuale. Matja e modelit HPK pasqyron modelin e përgjithshëm të përkeqësimit ose përmirësimit të cilësisë së kredisë së instrumenteve financiare, të shprehur në drejtim të rritjes së konsiderueshme të kredisë.

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare
Për vitin qe ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020
(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Rritja e ndjeshme në riskun kreditor (vazhdim)

Kur instrumentet financiare fillimisht gjenerohen, kompensimi i humbjes matet në një shumë të barabartë me humbjet e pritura të kredisë 12-mujore. Kur risku i vonesave të instrumentit është rritur ndjeshëm që nga krijimi i tij, Banka do të mas lejimin e humbjes në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kredisë.

Banka do të monitorojë efektivitetin e kritereve të përdorura për të identifikuar rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë me rishikime të rregullta për të konfirmuar se:

- kriteret janë të afta të identifikojnë rritje të konsiderueshme të riskut kreditor para se një ekspozim të jetë në vonesë;
- koha mesatare midis identifikimit të një rritje të konsiderueshme të riskut kreditor dhe parazgjedhjes duket e arsyeshme; dhe
- ekspozimet në përgjithësi nuk transferohen direkt nga matja e HPK 12-mujore ndaj rënjës së vleres të kredisë.

Përcaktimi nëse risku kreditor është rritur ndjeshëm

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse risku kreditor (d.m.th. risku i vonesës) për një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Banka do të konsiderojë informata të arsyeshme dhe të mbështetshme që janë relevante dhe të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme, informacion cilësor dhe analiza bazuar në përvojën historike të Bankës, vlerësimin e kredive të ekspertëve dhe informacionin e ardhshëm.

Banka do të identifikojë kryesisht nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e riskut kreditor për një ekspozim që ndryshon klasifikimin e riskut rregullator nga standardi për tu shikuar në përputhje me politikën e Bankës për klasifikimin e riskun rregullator. Të gjitha kreditë që shfaqin rritje të ndjeshme në riskun kreditor klasifikohen në Kategorinë 2.

Si një rezervë, dhe siç kërkohet nga SNRF 9, Banka me gjasë do të konsiderojë se një rritje e ndjeshme e riskut kreditor ndodh jo më vonë se kur një pasuri është më shumë se 30 ditë në vonesë. Banka do të përcaktojë ditët e kaluara duke numëruar numrin e ditëve që nga data më e hershme e kaluar për të cilën pagesa e plotë nuk është pranuar.

Si një rezervë tjetër, Banka do të konsiderojë si një rritje e ndjeshme e riskut kreditor, nëse kredia klasifikohet nga standardi në ndjekje ose në një klasë më të keqe të riskut ose kreditë e tjera të të njëjtit klient me Bankën janë klasifikuar nga standardi në ndjekje ose në një shkallë më keq të riskut. Banka gjithashtu do të konsiderojë që risku është rritur nëse klienti kërkon një ristrukturim me masa lehtësuese siç janë: maturimi i zgjatur, kësti më i ulët, norma e interesit më e ulët, përjashtimet nga ndëshkimet dhe interesi i akumuluar.

Grupimi i kredive

Vlerësimi i përgjithshëm i probabilitetit të dështimit (PD)

Për qëllime të një vlerësimi të përgjithshëm të PD-së, BPB grupon kreditë në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut kreditor që janë tregues i aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat e duhura sipas kushteve kontraktuale.

Duke marrë parasysh profilin e riskut kreditor për kreditë e saj, BPB ka zgjedhur të grupojë kreditë në bazë të tipit të klientit (bizneset e mëdha dhe të mesme, bizneset e vogla, individët) dhe llojit të produktit (biznesore, hipotekare, konsumuese).

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Grupimi i kredive (vazhdim)

Vlerësimi i përgjithshëm i probabilitetit të dështimit PD (vazhdim)

Egziston një segmentim i portfolios së kredive bazuar ne karakteristikata e ngjajshme te riskut.Më poshtë jane paraqitur 7 segmente te portfolios se kredisë dhe te kartave te kreditit:

- Korporatë
- Mikro
- Agro
- Hipotekare
- Veteranet dhe Invalidet
- Konsumuese
- Kartat e kreditit

Vlerësimi përgjithëshem i kredive në dështim (KND)

Për qëllim të vlerësimit të përgjithëshem KND-ve, kreditë janë grupuar në bazë të:

- ciklit rë rikuperimit të mjeteve monetare për kreditë jo përformuese;
- lloji i kolateralit (d.m.th. kolateral i pasurive të paluajtshme); dhe
- kthimi pas shlyerjeve.

BPB rishikon në bazë vjetore kufijtë dhe kriteret e përcaktuara për të siguruar që ato të mbeten të vlefshme pas ndryshimeve të mundshme në madhësinë dhe përbërjen e portofolit të kredive.

Pasuritë financiare të ndryshuara

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të ndryshohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientëve dhe faktorëve të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim të tanishëm ose potencial të kredisë së klientit. Një kredi ekzistuese, kushtet e të cilave janë modifikuar, mund të ç'regjistrohen dhe kredia e rinegociuar të njihet si një kredi e re me vlerë të drejtë.

POCI: Pasuritë e blera ose të gjeneruara nga rënia në vlerë (POCI) janë pasuritë financiare që kanë rënë në vlerë në njohjen fillestare. Këto pasuri regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një EIR të rregulluar nga kredia. HPK-të njihen vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritshme të kredisë. Për pasuritë financiare për të cilat Banka nuk ka shpresa të arsyeshme për mbulimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjese të saj, vlera kontabël bruto e pasurisë financiare zvogëlohet. Kjo konsiderohet një çregjistrim (i pjesëshëm) i pasurisë financiare.

Sipas SNRF 9, kur kushtet e një pasurie financiare ndryshohen dhe modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim, Banka do të shqyrtojë nëse risku kreditor së pasurive është rritur ndjeshëm duke analizuar faktorët sasiorë dhe cilësorë që ndikojnë në riskun e dështimit.

Banka rinegocion kredi për klientët në vështirësi financiare (të referuara si 'aktivitete të ristrukturimit') për të maksimizuar mundësitë e grumbullimit dhe minimizuar riskun e dështimit. Sipas politikës së ristrukturimit të bankës, ristrukturimi i kredisë jepet në baza selektive nëse debitori momentalisht është në vonesë të borxhit të tij ose nëse ka një risk të lartë të vonesës, ka dështmi se debitori ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të paguar sipas kontratës fillestare kushtet dhe debitori pritet të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e rishikuara.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Pasuritë financiare të ndryshuara (vazhdim)

Termat e rishikuara zakonisht përfshijnë zgjatjen e maturimit, ndryshimin e kohës së pagesave të interesit dhe ndryshimin e kushteve të konvenantave të kredisë. Si kreditë individuale ashtu edhe ato biznesore janë subjekt i politikës së ristrukturimit të borxhit.

Në përgjithësi, ristrukturimi është një tregues cilësor i voneses dhe renjës ne vlerë kreditore dhe pritjet e ristrukturimit janë të rëndësishme për të vlerësuar nëse ka një rritje të konsiderueshme të riskut kreditor.

Pas ristrukturimit, një klient duhet të tregojë sjellje të mirë pagese në menyre te qëndrueshme përpara se ekspozimi të matet në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore.

Inputet në matjen e HPK-së

Inputet kryesore në matjen e HPK-ve ka të ngjarë të jenë termi strukturat e ndryshoreve të mëposhtme:

- probabiliteti i dështimit PD;
- kreditë ne dështim (KND); dhe
- ekspozimi në dështim (END).

Këta parametra do të rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara brenda vendit dhe të dhëna të tjera historike që përdorin modelet rregullatore. PD-të do të rregullohen për të pasqyruar informacionin e ardhshëm si më poshtë.

Nivelet e riskut kreditor do të jenë një input primar në përcaktimin e strukturës së afateve të PD për ekspozimet. Banka do të përdorë modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të PD të jetës së mbetur të ekspozimeve si dhe këto pritet të ndryshojnë si pasojë e kalimit të kohës.

Kjo analizë do të përfshijë identifikimin dhe kalibrimin e marrëdhënieve ndërmjet ndryshimeve në normat e vonuara dhe ndryshimet në faktorët kryesorë makroekonomikë, si dhe analizën e thellë të ndikimit të disa faktorëve të tjerë (p.sh. përvojën e ristrukturimit) në riskun e vonesës. Për shumicën e ekspozimeve, treguesit kryesorë makroekonomikë ka të ngjarë të përfshijnë rritjen e GDP-së, normat e interesit dhe papunësinë. Qasja e Bankës për përfshirjen e informacioneve të ardhshme në këtë vlerësim është diskutuar më poshtë.

KND është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka vonesa. Banka do të vlerësojë parametrat KND bazuar në historinë e normave të rikuperimit të kërkesave ndaj palëve të kundërta. Modelet KND do të konsiderojnë strukturën, kolateralin, vjetërsinë e kërkesës dhe kostot e rimëkëmbjes së çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e pasurive financiare. Për kreditë e siguruara nga prona me pakicë, raportet e kredisë për vlerën (KPV) ka të ngjarë të jenë një parametër kyç në përcaktimin e KND.Vlerësimet KND do të kalibrohen për skenarë të ndryshëm ekonomikë dhe, për huadhënien e pasurive të paluajtshme, të pasqyrojnë ndryshimet e mundshme në çmimet e pronës. Ato do të llogariten në bazë të rrjedhës së parasë të diskontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor diskontues.

ENV përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një vonese. Banka do të nxjerr ENV nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës, përfshirë amortizimin dhe parapagimet. ENV e një pasurie financiare do të jetë vlera kontabël bruto në vonesë. Për angazhimet e huadhënies dhe garancionet financiare, END do të shqyrtojë shumën e tërhequr, si dhe shumat potenciale të ardhshme që mund të tërhiqen ose paguhen sipas kontratës, të cilat do të vlerësohen bazuar në vrojtimet historike dhe parashikimet e ardhshme.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Inputet në matjen e HPK-së (vazhdim)

Banka do të matë HPK-të duke marrë në konsideratë riskun e vonesës për periudhën maksimale kontraktuale (duke përfshirë opsionet e zgjerimit të huamarrësit) mbi të cilat ai është i ekspozuar ndaj riskut kreditor, edhe nëse për qëllime të administrimit të riskut Banka konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie ose të përfundojë një angazhim kredie apo garancion.

Për mbitërheqjet individuale dhe kartelat kreditore dhe disa produkte kreditore biznesore që përfshijnë si një kredi dhe një element të zotimit të patërhequr, Banka do të matë HPK-të për një periudhë më të gjatë se periudha maksimale kontraktuale, nëse aftësia kontraktuale e Bankës për të kërkuar shlyerjen dhe anulimin e zotimit të paterhequr nuk e kufizon ekspozimin e Bankës ndaj humbjeve të kredisë në periudhën e njoftimit kontraktual. Këto produke nuk kanë një afat të caktuar ose strukturë të ripagimit dhe menaxhohen në baza kolektive. Banka mund t'i anulojë ato me efekt të menjëhershëm, por kjo e drejtë kontraktuale nuk zbatohet në menaxhimin normal të përditshëm, por vetëm kur Banka të dijë për një rritje të riskut kreditor në nivel të produktit. Kjo periudhë më e gjatë do të vlerësohet duke marrë parasysh veprimet e menaxhimit të riskut kreditor që Banka pret të ndërmarrë dhe që shërbejnë për të zbutur HPK-të. Këto përfshijnë një ulje të limiteve dhe anulimin e produkteve.

Kur modelimi i një parametri kryhet në baza kolektive, instrumentet financiare do të grupohen në bazë të karakteristikave të përbashkëta të riskut që përfshijnë:

- Lloji i instrumentit; dhe
- klasifikimi i riskut kreditor.

Grupimi do t'i nënshtrohet rishikimit të rregullt për të siguruar që ekspozimet brenda një grupi të veçantë të mbeten në mënyrë të përshtatshme homogjene.

Për investimet në letrat me vlerë të borxhit në lidhje me të cilat Banka ka të dhëna të kufizuara historike, informacion i jashtëm i referencës i publikuar nga agjencitë e njohura të vlerësimit të jashtëm të kreditit të tilla si Moody's përdoren për të plotësuar të dhënat në dispozicion brenda vendit.

Informacionet e ardhshme

Sipas SNRF 9, Banka përfshinë informacione të ardhshme në të dyja vlerësimet e saj nëse riskut kreditor i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe matja e saj HPK-së. Banka formulon një pamje "të rastit bazë" të drejtimit të ardhshëm të variablave përkatëse ekonomike dhe një gamë përfaqësuese të skenarëve të tjerë të mundshëm të parashikimit bazuar në këshillat e Komitetit të Riskut të Bankës dhe ekspertëve ekonomikë dhe shqyrtimin e një sërë informacionesh të jashtme aktuale dhe parashikuese.

Ky proces përfshinë zhvillimin e dy ose më shumë skenarëve ekonomikë shtesë dhe duke marrë parasysh probabilitetet relative të secilit rezultat. Informacioni i jashtëm mund të përfshijë të dhëna ekonomike dhe parashikime të publikuara nga organet qeveritare dhe autoritetet monetare në vendet ku vepron Banka, organizata mbikombëtare si Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe sektori privat i përzgjedhur dhe parashikuesit akademik.

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare
Për vitin qe ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020
(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Informacionet e ardhshme (vazhdim)

Rasti bazë paraqet një rezultat më të mundshëm dhe përafrohet me informacionin e përdorur nga Banka për qëllime të tjera, siç janë planifikimi strategjik dhe buxhetimi. Skenarët e tjerë do të përfaqësojnë rezultate më optimiste dhe më pesimiste. Banka gjithashtu në mënyrë periodike kryen testimin e stresit të goditjeve më ekstreme për të kalibruar përcaktimin e saj për këto skenarë të tjerë përfaqësues.

Banka ka identifikuar dhe dokumentuar drejtuesit kryesorë të riskut kreditor dhe humbjeve të kredisë për secilin portofol të instrumenteve financiare dhe, duke përdorur një analizë të të dhënave historike, ka vlerësuar marrëdhëniet midis variablave makro-ekonomik dhe rrezikut të kredisë dhe humbjeve të kredisë. Këta drejtues kryesorë përfshijnë normat e interesit, nivelet e papunësisë dhe parashikimet e GDP-së. Marrëdhëniet e parashikuara midis treguesve kryesorë dhe niveleve të humbjeve dhe humbjeve në portfolio të ndryshme të pasurive financiare janë zhvilluar bazuar në analizën e të dhënave historike gjatë 5 viteve të fundit.

Paraqitja e lejimeve për HPK-në në pasqyrën e pozicionit financiar

Lejimet për humbjen për HPK paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

- pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar: si zbritje nga vlera kontabël bruto e pasurive;
- zotimet e kredisë dhe kontratat e garancioneve financiare: në përgjithësi, si një provizion;
- kur një instrument financiar përfshin një komponent të tërhequr dhe një element jo të tërhequr, dhe Banka nuk mund të identifikojë HPK-në në përbërësin e zotimit të kredisë veçmas nga ato të përbërësit të tërhequr: Banka paraqet një kompensim humbjeje të kombinuar për të dy komponentët. Shuma e kombinuar paraqitet si zbritje nga vlera kontabël bruto e përbërësit të tërhequr. Çdo tejkalim i lejimit të humbjes mbi shumën bruto të përbërësit të tërhequr paraqitet si provizion; dhe
- instrumente të matura në VDATGJ: asnjë provizion per humbje nuk njihet në pasqyrën e pozicionit financiar sepse vlera kontabël e këtyre pasurive është vlera e drejtë e tyre. Sidoqoftë, provizioni i humbjes shpaloset në shënimin 14.

Pasuritë financiare të ristrukturuara

Nëse kushtet e një pasurie financiar rinegociohen, modifikohen ose një pasuri financiare ekzistuese zëvendësohet me një të re për shkak të gjendjes së vështirë financiare të huamarrësit, atëherë bëhet një vlerësim nëse pasuria fianciare duhet të çregjistrohet (shih Shënimin 3f)(iii)) dhe ECL maten si mëposhtë.

- Nëse ristrukturimi i pritur nuk rezulton me çregjistrim të pasurisë ekzistuese, atëherë rrjedhja e pritur e parasë që vie nga pasuritë financiare të ndryshuara janë të përfshira në llogaritjen e humbjeve të parave nga pasurive ekzistuese.
- Nëse ristrukturimi i pritur do të rezultojë në çregjistrim të pasurisë ekzistuese, atëherë vlera e drejtë e pritur e pasurisë trajtohet si rrjedhja përfundimtare e parasë nga pasuria ezistuese në momentin e regjistrimit. Kjo shumë përfshihet në kalkulimin e humbjeve të parasë nga pasuritë ekzistuese financiare që janë zvogëluar nga data e pritur e çregjistrimit tek data e raportimit duke zbatuar normën efektive origjinale të interesit në pasurinë ekzistuese financiare.

Pasuritë financiare të provizionuara

Në secilën datë raportimi, grupi vlerëson nëse pasuritë financiare të amortizuara, pasuritë financiare të borxhit të bartur në VDPFH dhe të arketueshmet e qirave financiare janë të zhvlerësuara nga kreditë (referuar si "Faza 3 Pasuritë Financiare").

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Pasuritë financiare të shlyera (vazhdim)

Evidenca që një pasuri financiare është provizionuar përfshinë të dhënat e observuara si mëposhtë:

- vështirësi të konsiderueshmë financiare të huamarrësit ose emetuesit;
- një shkelje e kontratës siç është një ngjarje në vonesë ose e dështuar;
- një ristruktutim të kredisë ose të paradhënies nga banka me kushte të cilat banka nuk i konsideron ndryshe;
- po bëhet me e qartë që huamarrësi të falimentojë ose do ketë ndonjë riorganizim tjetër financiar; ose
- largimi i letrave me vlerë nga tregu për shkak të vështirësive financiare.

Një kredi që është rinegociuar për shkak të një përkeqësimi të gjendjes së huamarrësit zakonisht konsiderohet si lejime-për-kredi përveç nëse ka arsye që rreziku i mos-pranimit të vlerave monetare kontraktuale është ulur ndjeshëm dhe nuk ka tregues tjerë të lejimeve. Gjithashtu, një kredi individuale që është në vonesë mbi 90 ditë konsiderohet e provizionuar.

Pasuritë financiare POCI

Pasuritë financiare POCI janë pasuri që janë lejime të kredisë gjatë njohjës fillestare. Për pasuritë POCI, jetëgjatësia HPK është e përfshirë në llogarijen e normës efektive të interesit që nga njohja fillestare.

Si pasojë, asetet POCI nuk mbajnë lejime të provizioneve gjatë njohjes fillestare. Shuma e njohur si lejime të humbura pasuese e njohjes fillestare është e barabartme me ndryshimet në jetëgjatësine HPK qe nga njohja fillestare.

Kreditë e shlyera

Kreditë dhe obligacionet shlyhen (pjesërisht ose plotësisht) kur nuk ka asnjë përspektivë reale të rimëkëmbjes. Kjo ndodh zakonisht në rastet kur Banka përcakton që huamarrësi nuk ka pasuri ose burime të mjaftueshme të të ardhurave që mund të gjenerojnë rrjedhje të mjatueshme të parasë për të shlyer shumat që i nënshtrohen fshirjes.
Sidoqoftë, pasuritë financiare që janë shlyer mund të jenë ende subjekt i zbatimit të aktiviteteve në mënyrë që të jenë në përputhje me procedurat e Bankës për rikuperimin vlerave në vonesë.

g) Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë monedhat dhe kartëmonedhat në arkë, gjendjet në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorimin e pasurive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë risk të pa konsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e zotimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

h) Depozitat, huamarrjet dhe borxhet e varura

Depozitat, huazimet dhe borxhet e varura janë burimet kryesore të Bankës për financim.

Depozitat, huazimet dhe kreditë e varura maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

i) Pasuritë e riposeduara

Kolaterali i mbajtur në bazë të marrëveshjes së kredisë mund të posedohet nga Banka vetëm në rast të falimentimit të huamarrësit dhe kryerjes së procedurave ligjore në përputhje me legjislacionin e Kosovës që i mundëson Bankës të marrë titullin e plotë juridik dhe pronësinë. Vetëm pas përfundimit të këtyre procedurave, Banka mund të shesë ose transferojë kolateralin. Pasuritë e riposeduara fillimisht njihen në shumën e përcaktuar me urdhër të gjykatës dhe më pas maten me vlerën më të ulët të kostos dhe vlerën neto të realizueshme dhe çdo fitim ose humbje nga shitja e këtyre pasurive njihet në fitim ose humbje.

Nga njohja fillestare, Banka klasifikon pasurinë e riposeduar në minimum si klasifikim nën standard dhe rezervon provizionimin sipas klasifikimit. Përveç kësaj, Banka njeh kolateralin e riposeduar si një pasuri vetëm kur ka titull të plotë juridik të kolateralit dhe vlera e drejtë e kolateralit mund të përcaktohet me besueshmëri. Banka nuk mund të shesë, transferojë ose ri-pengojë kolateralin nëse procedurat ligjore për transferimin e pronësisë si rezultat i vonesës nuk janë plotësuar. Banka mban posedimin e pronave të fituara përmes zbatimit në formën e një hipoteke, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh. Nëse, brenda pesë vjetësh, pasuria nuk është shitur nga Banka, ajo shënohet me zero vlerë.

j) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë matur sipas kostos minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga rënia në vlerë.

Kostot historike përfshijnë shpenzime që janë drejtpërdrejtë të lidhura me blerjen e pasurisë. Softueri i blerë që është thelbësor për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje.

Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato llogariten si artikuj të veçantë (përbërësit madhor) të pronës dhe pajisjeve.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të një zëri të pronës dhe pajisjeve aktive (llogaritur si diferencë midis të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël neto të zërit), njihet në të ardhura të tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kostot pasuese janë kapitalizuar vetëm kur vërtetohet që benefitet ekonomike të ardhshme të atij shpenzimi do të rrjedhin në bankë. Riparimet e vazhdueshme dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në shpenzime në periudhën që kanë ndodhur.

(iii) Zhvlerësimi

Zërat e pasurisë dhe pajisjet amortizohen nga data kur ato janë në dispozicion për përdorim. Amortizimi është llogaritur për të shlyer koston e zërave të pronës dhe pajisjeve minus vlerën e mbetur të tyre të vlerësuara gjatë jetës së dobishme të përdorimit. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

j) Prona dhe paisjet (vazhdim)

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve. Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe krahasuese është si vijon:

	Jetëgjatësia
Ndërtesat	20 vite
Kompjuteret dhe pajisjet e ngjashme	5 vite
Automjetet	5 vite
Mobilje dhe pajisje	5 vite

Përmirësimet e objekteve me qira zhvlerësohen duke përdorur metodën lineare gjatë afatit më të shkurtër të qirasë, dhe të jetës së tyre të dobishme. Jeta e dobishme e përmirësimeve në objektet e marruar me qira është 5 vjet.
Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia e dobishme dhe vlerat e mbetura janë ri-vlerësuar në datën e raportimit dhe janë rregulluar atëherë kur duhet.

k) Pasuritë e paprekshme

Softuerët e blerë nga Banka janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe minus ndonjë humbje e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi pasuritë e sofverëve kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë specifike për të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje gjatë jetës së dobishme të pasurisë, që nga data që është në dispozicion për përdorim.

Softueri amortizohet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së dobishme prej pesë viteve.

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme

l) Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të Bankës, përveç pasurive për tatime të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një pasurie e tejkalon shumën e saj të rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e një pasurie është më e madhe nga vlera e tij në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostoja për shitje.

Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhat e ardhshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflektojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë.

Humbjet nga rënia në vlerë janë njohur në fitim apo humbje. Humbja nga rënia në vlerë kthehet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk është njohur humbja nga rënia në vlerë.

m) Provizionet

Një provizion njihet nëse si pasojë e një ngjarje të mëparshme, ku Banka ka një obligim ligjor aktual apo konstruktiv që mund të vlerësohet me saktësi, dhe ka mundësi që një dalje e të mirave materiale do të kërkohet për të shlyer obligimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhën e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e parasë në kohë dhe sipas rastit, me risqet specifike të detyrimit. Diskontimi i pashmangshëm njihet si kosto financiare.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

n) Përfitimet e punonjësve

(i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme që ofrojnë përfitime në formë të pensioneve për punonjësit me rastin e pensionimit. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pensione.

(ii) Përfitimet afatshkurtëra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punëtorëve maten mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime në momentin e ofrimit të shërbimit. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet sipas një bonusi afatshkurtër në të holla ose sipas planit për ndarjen e fitimit nëse Banka ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar këtë vlerë si rezultat i shërbimeve në të kaluarën të ofruara nga punonjësi me ç'rast detyrimi mund të vlerësohet me saktësi.

o) Garancionet financiare dhe Zotimet për hua

Përgjegjësi e Bankës sipas secilit zotim matet me vlerën më të lartë të shumës së njohur fillimisht minus amortizimi kumulativ i njohur në pasqyrën e të ardhurave, dhe provizioni sipas matjes me HPK. Për këtë qëllim, Banka vlerëson HPK-të bazuar në vlerën aktuale të pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin për një humbje kredie që ajo shkakton. Mangësitë janë zbritur nga një përafrim me normën e interesit të rregulluar nga risku që lidhet me ekspozimin. HPK-të që lidhen me kontratat e garancioneve financiare njihen brenda provizioneve.

Garancionet financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lindë kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Angazhimet për hua janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të para-përcaktuara. Angazhime të tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

p) Dividendët

Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen në ekuitet në periudhën në të cilën ato janë miratuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit janë paraqitur si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit.

q) Rezervat e ekuitetit

Rezervat e regjistruara në ekuitet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës përbëhen nga:

- Rezerva e vlerës së drejtë, që përfshinë ndryshimet në vlerën e drejtë të pasurive financiare në vlerën e drejtë përmes investimeve në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse;
- Rezervat tjera të kapitalit, që përfshinë dallimin ndërmjet humbjeve të akumuluara sipas SNRF dhe BQK;
- Rezerva e rivlerësimit, që përfshinë kolateralin e ri poseduar të regjistruar në pasuri dhe pajisje nga Banka.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Menaxhmenti zgjedh dhe shpalos politikat kontabël kritike të Bankës dhe zbatimin e tyre si dhe supozimet e bëra në lidhje me pasiguritë e mëdha të vlerësimit. Informacioni në lidhje me supozimet dhe vlerësimet e pasigurive që kanë një risk të rëndësishëm të rezultojnë në një rregullim material brenda vitit të ardhshëm financiar dhe për gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta janë shpalosur më poshtë.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e riskut financiar (shih Shënimin 26).

a) Humbjet e pritshme kreditore

Pasuritë finanicare e llogaritura me kosto të amortizuar ose VDATGJ vlerësohen për rënie në vlerë në bazë të shënimit 3. (f). (vi). Banka rishikon vlerësimet dhe gjykimet në baza të rregullta.

Banka mat humbjet e pritshme nga kreditë të një instrumenti financiar në një mënyrë që reflekton:

(i) një sasi të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme;

(ii) vlera kohore e parave; dhe

(iii) informacione të arsyeshme dhe të mbështetura që janë në dispozicion pa kostot dhe përpjekjet e panevojshme në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

Përhapja e COVID-19

Përhapja e COVID-19 përbën një ngjarje të rëndësishme dhe burim pasigurie, i cili kërkon që menaxhmenti të zbatojë gjykime dhe vlerësime në vlerësimin e ndikimit të saj në pozicionin financiar dhe performancën.

Gjatë vitit financiar 2020, pandemia COVID-19 është përhapur në rajonin në të cilin vepron Banka duke ndikuar në aktivitetet ekonomike të Bankës dhe profitabilitetin që rezulton.

Ngadalësimi i aktiviteteve ekonomike ka ndikuar në disa nga kategoritë e të ardhurave (interesat nga kreditë) për shkak të rënies shoqëruese të tregjeve financiare. Disa shpenzime të jashtëzakonshme janë kryer gjithashtu pasi atyre u kërkohej të jepnin komunikime të vazhdimësisë së biznesit dhe siguri të përshtatshme në dritën e pandemisë.

Mjedisi i tregut u ndikua nga pasiguritë në lidhje me zhvillimet ekonomike dhe shkalla e rimëkëmbjes ekonomike në periudhat e ardhshme, si dhe evolucioni i pandemisë.

(i) Ndikimi i COVID-19 në matjen e pasurive financiare dhe jo-financiare të njohura në bilancin e gjendjes

Ekspozimet ndaj kredisë

Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik që rezulton nga pandemia COVID-19 dhe masat e lidhura të bllokimit kanë ndikuar në vlerësimet e rikuperueshmërisë së ekspozimeve kreditore dhe llogaritjen e provizioneve të humbjeve të kredisë.

Shuma e provizioneve të humbjes së kredisë përcaktohet duke marrë parasysh klasifikimin aktual dhe të pritur të ekspozimeve të kredisë dhe parametrave të kredisë (Probabiliteti i Mospagimit, Humbja e Paracaktuar dhe Ekspozimi në Mospagim) të cilat, në përputhje me SNRF 9 përfshijnë midis faktorëve të tjerë informacionin e ardhshëm dhe evolucioni i skenarit makro-ekonomik.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

Përhapja e COVID-19 (vazhdim)

Në këtë kontekst, Banka ka azhurnuar skenarët makro-ekonomikë në 31 Dhjetor 2020, duke konsideruar përveç një skenari bazë edhe një skenar të pafavorshëm dhe një skenar pozitiv dhe duke zbatuar faktorët e peshimit në skenarë.

a) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Tabela më poshtë tregon peshat e skenarëve makroekonomikë para pandemisë COVID-19 dhe në dhjetor 2020.

Peshat për skenarët e makroekonomisë

Skenari	Para COVID-19	Dhjetor 2020
Thelbësore	34%	34%
Pozitiv	33%	16%
Negativ	33%	50%

Bazuar në tabelën më sipër, në fund të vitit 2020 mbulimi i portofolit të performancës nga humbjet e pritura të kredisë u rrit me 1.25 bp krahasuar me fundin e vitit 2019, ndërsa pjesa e huave të fazës 2 në gjithsej kreditë në vitin 2020 u rrit me 7.06 bp, ose me 14.35 milion Euro.

Mbulueshmëria e portfolios performuese HPK

Dhjetor 2019	Mars 2020	Qershor 2020	Shtator 2020	Dhjetor 2020
0.46%	0.68%	1.04%	0.93%	1.71%

Raporti i kredisë në fazën 2

Dhjetor 2019	Mars 2020	Qershor 2020	Shtator 2020	Dhjetor 2020
1.83%	1.89%	1.84%	2.08%	8.89%

Matja ndikohet nga shkalla e pasigurisë në evolucionin e pandemisë, efekti i masave të ndihmës dhe, në fund të fundit, fillimi dhe shkalla e rimëkëmbjes ekonomike.

Evolucioni i këtyre faktorëve mund të kërkojë në vitet e ardhshme financiare klasifikimin e ekspozimeve shtesë të kredisë si joperformuese, duke përcaktuar kështu njohjen e provizioneve shtesë të humbjeve të kredisë në lidhje me të dyja këto ekspozime, si dhe kryerjen e ekspozimeve pas azhurnimit në parametrat e kredisë. Në këtë kontekst, midis faktorëve të tjerë, e rëndësishme do të jetë aftësia e klientëve për të shërbyer borxhin e tyre pasi të mbarojnë masat e marra nga moratoriumi.

Rregullimet e provizioneve të humbjes së kredisë mund të kërkohen nga shfaqja e një skenari makro-ekonomik të ndryshëm nga ai i vlerësuar për llogaritjen e parametrave të rrezikut të kredisë, ose nga mbizotërimi i ekspozimeve me probleme në treg.

(i) Programet e ndihmës COVID-19 për klientët

Për të mbështetur klientët tanë të korporatave dhe shitjeve me pakicë, Banka dha masa lehtësuese duke përfshirë moratoriumin dhe planifikimin siç udhëzohet nga BQK-ja.

Më 31 dhjetor 2020, më shumë se 300 klientë po përfitojnë nga masat e ndihmës. Tabela e mëposhtme përmbledh vlerat shoqëruese kontabël të papaguara për kreditë e planifikuara për shkak të masave Covid-19.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

Përhapja e COVID-19 (vazhdim)

		Vlera kontabël bruto			Zhvlerësimi i akumuluar		
	Numri i detyruesve	Total	Performuese	Jo-performuese	Total	Performuese	Jo-performuese
Kreditë dhe paradhëniet në varësi të masave të riprogramimit që lidhen me Covid-19	301	14,645	14,304	341	1,731	1,553	178
Prej të cilave: Kredi Korporatë	277	14,480	14,168	311	1,697	1,535	162
Prej të cilave: Kredi të kolateralizuara nga prona të paluajtshme tregtare	35	5,923	5,862	61	804	742	61
Prej të cilave: Kredi Individuale	24	165	136	29	34	18	16
Prej të cilave: Kredi të kolateralizuara nga prona të paluajtshme banesore	1	18	18	-	-	-	-

Banka do të vazhdojë të mbështesë klientët dhe të vlerësojë në mënyrë adekuate aftësinë e tyre për kreditim, duke konsideruar me kujdes adekuatëshmërinë e klasifikimit të rrezikut si dhe ndikimin e lidhur me të në raportimin financiar.

Në përputhje me udhëzimet e BQK-së dhe BQE-së, disponueshmëria e këtyre masave lehtësuese për një popullatë të përgjithshme të klientëve nuk ishte në vetvete një shkas automatik për klasifikimin në kategorinë e riprogramuar ose për të arritur në përfundimin se një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë ka ndodhur për të gjithë klientët që kanë përdorur masat.

(ii) Monitorimi I aktiviteteve

Pas futjes së masave COVID-19 për të ndihmuar ekonominë, Banka intensifikoi më tej aktivitetet e monitorimit të portofolit të klientëve, me përparësi të veçantë për klientët që përdorin ose kanë përdorur disa nga masat COVID-19. Analiza kryhet jo më vonë se tre muaj nga kontraktimi i masës, ndërsa përparësia u jepet klientëve me masat e riprogramuara ose me vonesën në pagimin e detyrimeve ndaj Bankës.

Transferet nga Faza 2 në Fazën 1	7	(7)	-	-
Transferet nga Faza 2 në Fazën 3	-	-	-	-
Transferet nga Faza 3 në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	-	-
Ç'regjistrime tjera përveç kredive të shlyera	(389)	-	-	(389)
Ripagimet dhe ndryshimet në rrjedhat e parasë	1	-	1	2
Garancionet e reja ose te blera	301	-	7	308
Kreditë e shlyera	-	-	-	-
Ndikimi i valutave të huaja dhe lëvizjet tjera	-	-	-	-
Ndryshimi neto në Fitim dhe Humbje	1,875	5	13	1,893

Letër garancionet	Faza 1 HPK 12-muaj	Faza 2 HPK të përhershme	Faza 3 HPK të përhershme	Gjithsej
Vlera e HPK-së më 1 January 2020	2	1	13	16
Transferet:				
Transferet nga Faza 1 në Fazën 2	-	8	-	8
Transferet nga Faza 1 në Fazën 3	-	-	3	3
Transferet nga Faza 2 në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet nga Faza 2 në Fazën 3	-	-	8	8
Transferet nga Faza 3 në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	-	-
Ndryshimet në PD/KND/END	1	-	(8)	(7)
Ç'regjistrime tjera përveç kredive të shlyera	(1)	(1)	(6)	(8)
Garancionet e reja ose te blera	2	2	-	4
Kreditë e shlyera	-	-	-	-
Ndikimi i valutave të huaja dhe lëvizjet tjera	-	-	-	-
Ndryshimi neto në Fitim dhe Humbje	2	9	(2)	8
Vlera e HPK-së më 31 Dhjetor 2020	4	10	10	24

21. DETYRIMET TJERA DHE PROVIZIONET (VAZHDIM)

Letër garancionet	Faza 1 HPK 12-muaj	Faza 2 HPK të përhershme	Faza 3 HPK të përhershme	Gjithsej
Vlera e HPK-së më 1 January 2019	3	2	6	11
Transferet:				
Transferet nga Faza 1 në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet nga Faza 1 në Fazën 3	-	-	-	-
Transferet nga Faza 2 në Fazën 1	-	(2)	-	(2)
Transferet nga Faza 2 në Fazën 3	-	-	-	-
Transferet nga Faza 3 në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	-	-
Ndryshimet në PD/KND/END	(1)	-	1	-
Ç'regjistrime tjera përveç kredive të shlyera	(1)	-	-	(1)
Garancionet e reja ose te blera	1	-	7	8
Kreditë e shlyera	-	-	-	-
Ndikimi i valutave të huaja dhe lëvizjet tjera	-	-	-	-
Ndryshimi neto në Fitim dhe Humbje	(1)	(2)	8	5
Vlera e HPK-së më 31 Dhjetor 2019	2	-	14	16

22. E DREJTA E PËRDORIMIT TË PASURISË DHE DETYRIMET E QIRASË

E drejta e përdorimit të pasurisë dhe detyrimet e qirasë

Banka merr me qira zyre të ndryshme. Kontratatt e qirasë bëhen zakonisht për përiudha fikse nga 1 deri në 10 vite, por mund të kenë mundësi zgjatje siç përshkruhet me poshtë.

Deri me 31 Dhjetor 2018 qiratë e pronave, uzinave dhe pajisjeve klasifikoheshin ose me qira financiare ose qira operative. Nga 1 Januar 2019, qiratë njihen si një e drejtë e përdorimit të pasurisë dhe një detyrim përkatës nga data kur pasuria e marrë me qira bëhet e disponueshme për t'u përdorur nga Banka.

Banka e njeh të drejtën e përdorimit të pasurisë si në vijim:

	Ndertesat	Gjithsej
Vlera kontabël më 1 Janar 2019	1,417	1,417
Shtesat gjatë vitit	2,103	2,103
Disposals	(17)	(17)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(660)	(660)
Vlera kontabël me 31 Dhjetor 2019	2,843	2,843
Shtesat gjatë vitit	389	389
Disposals	(16)	(16)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(663)	(663)
Vlera kontabël me 31 Dhjetor 2020	2,553	2,553

Banka e njeh detyrimin e qirasë si në vijim:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Detyrimet afatshkurtër të qirasë	660	613
Detyrimet afatgjata të qirasë	1,952	2,212
Gjithsej obligimet e qirasë	2,612	2,825

23. KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT

Kapitali aksionar

Në pajtim me Ligjin nr. 04/L-093 për "Banka, Institucione Mikrofinaniare dhe Institucione Financiare Jo-Bankare"kapitali aksionar minimal për bankat që operojnë në Kosovë duhet të jetë 7 milion Euro.

Më 31 dhjetor 2020 kapitali aksionar i autorizuar ishte i përbërë nga 28,530 aksione të zakonshme (2019: 28,530 aksione të zakonshme). Aksionet e zakonshme kanë një vlerë nominale prej 394.2 Euro secili. Pronarët e aksioneve të zakonshme kanë të drejtë të marrin dividendë që deklarohen kohë pas kohe dhe kanë të drejtën e një vote për aksion në mbledhjet e Bankës. Të gjitha aksionet renditen në mënyrë të barabartë në lidhje me pasuritë e mbetura të Bankës.Një përmbledhje e strukturës së pronësisë është si vijon:

NR.	Emri i aksionarit	2020		2019	
		%	EUR	%	EUR
1	Afrim Govori	21.27	2,392	21.27	2,392
2	Rrustem Aliaj	17.27	1,942	17.27	1,942
3	Shaqir Palushi	11.81	1,328	11.81	1,328
4	EBRD	10.00	1,125	10.00	1,125
5	Mejdi Rexhepi	9.35	1,052	9.35	1,052
6	Moneta sh.p.k	7.77	874	7.77	874
7	Nazmi Viça	6.89	775	6.89	775
8	Kareman Limani	4.85	545	4.85	545
9	Banka di Cividale	4.62	520	4.62	520
10	Ahmet Arifi	2.39	269	2.39	269
11	Ismet Sylejmani	1.90	214	1.90	214
12	Luani Limited	0.44	49	0.44	49
13	Sokol Krasniqi	0.38	42	0.38	42
14	Naser Aliu	0.31	35	0.31	35
15	Besnik Vrella	0.31	36	0.31	36
16	Agim Bilalli	0.31	35	0.31	35
17	Flamur Bryma	0.09	10	0.09	10
18	Naim Abazi	0.04	4	0.04	4
Gjithsej		100.00	11,247	100.00	11,247

Rezervat tjera të kapitalit

Bazuar në rezerva tjera të kapitalit në rregulloret e BQK-së, duke filluar nga 1 janari 2020, të gjitha bankat në Kosovë kërkohet të përgatisin dhe paraqesin pasqyrat e tyre financiare vetëm bazuar në SNRF-të. Çdo ndryshim në provizionet e humbjes së huasë midis BQK-së dhe SNRF-së kornizën e raportimit do të njihet në Rezervën e Kapitalit Tjetër. Që nga 1 janari 2020, shuma e njohur si një ndryshim në rezervën e humbjes së kredisë midis standardeve të raportimit të BQK-së dhe SNRF-ve është 769 mijë euro.

Rrjedhimisht, bilanci i Rezervës tjetër të kapitalit në vlerë prej 857K EUR i njohur në 31 Dhjetor 2011 dhe i vlefshëm deri më 31 Dhjetor 2019 pushon së ekzistuari në mënyrë efektive 1 Janar 2020.

Rezervë tjetër e kapitalit në vlerë prej 857K EUR u krijua më 31 Dhjetor 2011 si diferencë midis humbjeve të akumuluara në përputhje me SNRF dhe BQK të cilat u shlyen përmes një reduktimi të kapitalit aksionar. Si rezultat, këto rezerva janë të kufizuara dhe nuk mund të shpërndahen.

Rezerva për rivlerësim

Gjatë vitit 2014, Banka ka vendosur të përfshijë në kategorinë e pronës dhe pajisjeve një ndërtesë e cila ka qenë me parë pasuri e riposeduar. Ndërtesa u njoh nga Banka në prona dhe pajisje me shumën korresponduese në rezervën e rivlerësimit në kapital.

23. KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT (VAZHDIM)

Kapitali aksionar (vazhdim)

Fitimet për aksion

Për qëllim të llogaritjes së fitimeve për aksion, fitimet përfaqësojnë fitimin neto pas taksës. Numri i aksioneve të zakonshëm është numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme të papaguara gjatë vitit. Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshëm të përdorura për të ardhurat bazë për aksion ishte 28,530 (2019: 28,530). Nuk ka asnjë efekt të mundshëm dobësimi nga asnjë instrument dhe kështu fitimet për aksion janë të njëjta me fitimet e dobësuara për aksion.

24. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Banka lëshon garancion për klientët e saj. Këto instrumente bartin një risk kreditimi të ngjashëm me ato te kredive të dhëna. Garancionet e lëshuara në favor të klientëve janë siguruar me kolateral në para dhe kolateral jo në para (pasuri të paluajtshme dhe kolateral të luajtshëm).

Garancionet e lëshuara të klientëve	2020	2019
Të siguruara me depozita kesh	1,407	1,202
Të siguruara me kolateral (patundshmëri dhe kolateral i luajtshëm)	679	690
Minus: Provizionet e njohura si detyrime	(24)	(16)
Gjithsej	2,062	1,876

Zotimet përfaqësojnë balancat e pa tërhequra të kredive, mbitërheqjeve dhe limitet e kredit kartelave të lëshuara të klientët.

Zotimet për kredi	2020	2019
Kreditë e aprovuara por të padisbursuara	-	-
Limitet e pashfrytëzuara te mbitërheqjeve	8,122	7,000
Kredit kartelat e pashfrytëzuara	475	508
Gjithsej	8,597	7,508

Ligjore

Banka është e përfshirë në procedura të zakonshme ligjore në rrjedhën e zakonshme të biznesit më 31 Dhjetor 2020. Menaxhmenti i Bankës është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet ligjore, përveç atyre që janë parashikuar dhe njohur si fitim ose humbje siç shpaloset në Shënimin 21.

Zotimet e qirasë

Zotimet e qirasë operative. Pagesat e ardhshme minimale të qirasë nen qiratë operative të pa anulueshme, ku Banka është qiramarrës, në 31 Dhjetor 2020 janë 365 EUR (2019: 298 EUR).

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

25.1 Hyrje dhe përmbledhje

Bank është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i pasurive financiare:

- Risku i kreditimit
- Risku i tregut
- Risku i likuditetit
- Rsiku operacional

Ky shënim prezanton informata për ekspozimin e bankës ndaj secilit nga risqet e përmendura më lartë, objektivin e Bankës, politikat dhe procedurat për matjen dhe menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Përgjigja ndaj riskut te COVID19

Më 11 Mars, 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli (OBSH) COVID-19 një pandemi globale, e cila së shpejti u pasua nga veprimet e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës përmes të cilave u vendosën një numër masash për të parandaluar dhe përmbajtur shpërthimin e koronavirus, të tilla si masat e distancës sociale, kufizimet e udhëtimit, karantina dhe direktivat e qëndrimit në shtëpi.Nën COVID-19, peisazhi i kërcënimit ndryshoi ndërsa u shfaqën rreziqe të reja. Këto rreziqe kishin të bënin kryesisht me qëndrueshmërinë operacionale të bankës, shëndetin dhe sigurinë e stafit, fuqinë financiare të klientëve dhe komunitetit të përgjithshëm, të cilat mund të ndikojnë thellësisht në rezultatet financiare të bankës.

Prandaj, në përgjigje të këtij ambienti dinamik dhe sfidues, u krijua një ekip i menaxhimit të krizave brenda bankës i cili trajtoi të gjitha veprimet që duhen ndërmarrë për të parandaluar përhapjen e virusit, për të vlerësuar vështirësitë financiare të klientëve dhe masat e tjera të nevojshme. Ky ekip përbëhej nga ekipe më të vogla të cilat ishin përgjegjëse për aspekte specifike të tilla si: menaxhimi ditor i likuiditetit, vlerësimi i aftësisë kreditore të klientëve dhe menaxhimi i mbledhjes, dhe qëndrueshmëria operacionale. Këto ekipe monitoronin dhe menaxhonin në mënyrë proaktive rreziqet duke mbledhur informacion në kohë, duke raportuar, duke kryer analiza të cilat shërbyen si bazë për procesin e vendimmarrjes në bordin e drejtorëve dhe nivelin e menaxhmentit.

Veprimet e ndërmarra nga banka për të adresuar rreziqet me të cilat përballen janë në fushat e mëposhtme:

- Qëndrueshmëria operacionale - në fillim banka duhej të reagonte shpejt në mënyrë që të zbatonte masat e vendosura nga qeveria. Kjo do të thoshte që banka duhej të zhvendoste rregullimin e punës nga zyra në punën nga shtëpia për një numër të stafit, i cili nga ana tjetër rriti nivelin e përçarjes në operacionet e bankës dhe gjithashtu rriti ekspozimin ndaj sjelljeve, rreziqeve kibernetike dhe privatësisë. Për më tepër, dobësitë ishin të dukshme edhe në zinxhirin e furnizimit dhe kjo krijoi pasiguri në lidhje me stabilitetin e furnizuesve kritikë të cilët, nëse nuk janë të disponueshëm, do të ndikonin në stabilitetin e operacioneve të bankës. Prandaj, gjatë kësaj kohe fokusi i bankës ishte në mbrojtjen e këtyre operacioneve duke ofruar mbështetje edhe për klientët. Në mënyrë që të ofrojë një mbështetje më të shpejtë dhe më të mirë, banka ndërmori iniciativa të ndryshme të cilat do ta afronin klientin me bankën dhe do t'i siguronin atij një përvojë më të personalizuar. Si i tillë, i gjithë fokusi për sa i përket shërbimit të biznesit ishte në dixhitalizimin e disa prej shërbimeve të cilat janë kryer në degë para COVID-19. Ne gjithashtu rritëm mbikëqyrjen e furnizuesve tanë kritikë në mënyrë që të monitorojmë ndikimin e COVID-19 në operacionet e tyre. Për sa i përket qeverisjes, bazuar në planin e përgjigjes së bankës, me identifikimin e stafit kritik, ne gjithashtu kemi hartuar planin e trashëgimisë dhe kemi identifikuar pasardhësit e drejtuesve të departamenteve në mënyrë që të sigurojmë që stafi i caktuar të jetë i gatshëm të marrë përsipër përgjegjësitë nëse gjykohet e nevojshme.

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

25.1 Hyrje dhe përmbledhje (vazhdim)

Përgjigja ndaj riskut të COVID19 (vazhdim)

- Shëndeti dhe siguria e punonjësve - një nga shqetësimet kryesore për ne gjatë kësaj periudhe ka qenë rritja e rrezikut për shëndetin dhe sigurinë e stafit tonë. Për këtë qëllim, ne kemi prezantuar shumë masa të cilat do të siguronin sigurinë e forcës sonë të punës dhe do të siguronin mbrojtje në vendin e punës në mënyrë që të parandalojmë përhapjen e virusit. Në mënyrë që të sigurohemi që shërbimet thelbësore të bankës ishin në dispozicion për klientët tanë dhe për të përmbushur rritjen e kërkesës së klientëve për ndihmë, ne shpejt adaptuam aranzhimet tona të punës, duke zhvendosur një pjesë të forcës së punës në punë të largët, ndërsa për forcën e punës të cilët qëndruan në zyra, ne i adaptuam ata në mënyrë që të mbanin distancën fizike dhe siguruam mjetet e nevojshme për të ndihmuar në parandalimin e përhapjes (dezinfektues dhe maska).
- Siguria kibernetike - Shfaqja e COVID-19 shfaqi një rritje të krimit kibernetik, ku dobësitë e klientëve ose dobësitë e mundshme të paraqitura për shkak të ndryshimeve të shpejta operacionale u shfrytëzuan nga kriminelët në internet synimet e të cilëve ishin të fitonin financiarisht. Për këtë qëllim, ne kemi punuar ngushtë me ekipin përgjegjës për sigurinë e informacionit në mënyrë që të rrisim programin e sigurisë kibernetike të bankës, i cili u përqendrua kryesisht në rritjen e ndërgjegjësimit të stafit, veçanërisht ata të stafit që punojnë nga shtëpia, përmes së cilës ata u siguruan një sërë udhëzimesh për të siguruar që stafi të jenë në përputhje me politikat e sigurisë së informacionit të bankës edhe gjatë kësaj kohe.
- Fuqia financiare – efekti përçarës i COVID-19 ka kontribuar në ngadalësimin ekonomik të ekonomisë globale dhe të Kosovës si dhe duke shkaktuar ndryshime në mjedisin makroekonomik. Pavarësisht masave lehtësuese të dhëna nga banka qendrore dhe qeveria për bizneset dhe individët, ndikimi i mundshëm në ekonomi vazhdon të jetë i pasigurt dhe si i tillë gjatë kësaj kohe ne kemi marrë masa të ndryshme për të vlerësuar cilësinë e kredisë së portofolit të kredisë dhe likuiditetin nivelet e bankës. Në fillim, treguesit e likuiditetit ishin subjekt i monitorimit dhe rishikimit ditor në nivel bordi dhe menaxhimi, ndërsa daljet e parave u administruan nga afër dhe i nënshtroheshin aprovimit nga nivele të ndryshme të autoritetit. Duke marrë parasysh që biznesi ynë kryesor është sigurimi i huazimit ose dorëzimi i burimeve huamarrësve, atëherë për të llogaritur efektet e mundshme të COVID-19 te klientët tanë, ne monitoruam portofolin tonë të kredisë duke vlerësuar këta klientë individualisht dhe duke adresuar nevojat e tyre. Në këtë drejtim, u kryen vlerësime të vazhdueshme të rrezikut për të llogaritur rritjen e rrezikut të kredisë që do të përkthehej në një rritje të provizioneve të humbjes së kredisë. Modelet e bankës të përdorura për një vlerësim të tillë janë të përqendruara në standardet IFRS9 dhe janë të kalibruar si të tilla për të marrë parasysh performancën e kaluar, ndërsa kanë një qasje shikimi përpara bazuar në zhvillimin e faktorëve makroekonomikë. Lidhur me ndikimin në biznes, ne kemi analizuar ndikimin e COVID-19 duke kryer teste stresi në drejtim të aktivitetit të huazimit, likuiditetit, mjaftueshmërisë së kapitalit dhe parashikimeve të tjera në lidhje me pozicionin financiar dhe përfitimin e bankës. Përkundër këtyre skenarëve, rezultatet tregojnë se banka do të vazhdojë të jetë fitimprurëse, do të ketë mbulim të mjaftueshëm me likuiditet, kapital dhe provizione dhe do të jetë në përputhje me kërkesat rregullatore të vendosura gjatë kësaj kohe.
- Masat e marra nga Qeveria – në pergjigje në përgjigje të kërcënimeve dhe rreziqeve të paraqitura në mjedisin ekonomik, Qeveria e Kosovës prezantoi masa lehtësuese të cilat kishin për qëllim sigurimin e një stimulimi për bizneset dhe individët. Masa të tilla përfshinin futjen e paketave të rikuperimit (paketa 1 dhe 2) përmes të cilave do të siguroheshin subvencione për palët e prekura në mënyrë që t'i ndihmonin ata të mbanin veten ose biznesin e tyre.

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

25.1 Hyrje dhe përmbledhje (vazhdim)

Përgjigja ndaj riskut të COVID19 (vazhdim)

Paketa e parë (paketa fiskale emergjente) u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30.03.2020, me qëllimin kryesor për të siguruar ndihmë të menjëhershme për komunitetin, kryesisht në zonat më të goditura nga pandemia. Ndihma u ofrua në formate të ndryshme, të tilla si: sigurimi i mbulimit të pjesshëm të pagave dhe qirave për një periudhë kohe, shtyrja e kësteve të huave për bizneset me vështirësi financiare, shtyrja e afateve të ripagimit të detyrimeve tatimore dhe sigurimi i mbështetjes shtesë për përfituesit e skemat sociale dhe pensionet.

Sa i përket paketës emergjente të krijuar nga qeveria për palët e prekura, banka e ka mbështetur këtë iniciativë duke rritur efikasitetin e procesit të hapjes së llogarisë përmes futjes së kanaleve dixhitale në mënyrë që klientët e prekur të marrin këto fonde.

Nga ana tjetër, pakoja e dytë (paketa e rimëkëmbjes ekonomike) u miratua nga Qeveria e Kosovës, fokusi kryesor i së cilës ishte të siguronte mbështetje kreditore për bizneset që përjetuan një rënie të aktivitetit ekonomik dhe të cilat janë me rëndësi strategjike për ekonominë e Kosovës. Në këtë drejtim, qeveria do të sigurojë garanci shtetërore përmes Fondit të Garancisë së Kredive të Kosovës për huatë që bizneset dhe qytetarët do të marrin nga bankat në mënyrë që të lehtësojë qasjen në financa për kategorinë e prekur të klientëve dhe për të rritur likuiditetin për NVM-të.

Përveç mbështetjes së kredisë, për të stimuluar kërkesën totale, qeveria lejoi tërheqjen e kursimeve pensionale (deri në 10%) nga qytetarët, për një pjesë të tyre rimbursimi do të sigurohet duke filluar nga viti 2023. Në mënyrë që të mbështesë këtë procesi, banka siguroi informacion në kohë për Fondin Pensional të Kosovës në përputhje me kërkesat për ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike.

- **Masat e marra nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK)** -duke marrë parasysh ndikimin e COVID-19 në ekonomi, në përputhje me masat lehtësuese të dhëna nga Qeveria për të mbështetur procesin e rimëkëmbjes, banka qendrore gjithashtu ofroi mbështetje për sektorin bankar me qëllimin kryesor për të ndihmuar bizneset dhe individët. Sipas vendimit të BQK-së, bankave iu kërkua të shtyjnë për një periudhë prej 3 muajsh kështet e kredisë për klientët që janë prekur nga COVID-19 (faza 1 nga 16 mars, 2020). Prandaj, për ta stimuluar këtë, banka qendrore pezulloi disa nga kërkesat rregullatore në lidhje me klasifikimin dhe provizionimin e humbjeve të kredisë nga Marsi në Dhjetor 2020. Në këtë drejtim, secili klient që kërkonte shtyrjen e kështit të kredisë u analizua individualisht. Në mënyrë që të rritet koha e përpunimit të këtyre kërkesave dhe numri i klientëve të tillë që vizitojnë degën, banka ka siguruar një platformë online ku klientët mund të paraqesin kërkesat e tyre. Pavarësisht pezullimit të kësteve për një periudhë 3 mujore, BQK-ja gjithashtu siguroi masa shtesë lehtësuese për ristrukturimin e kredive deri në 1 vit duke filluar nga Qershori 2020 (faza 2), me qëllimin kryesor për të ndihmuar kreditorët që po përballeshin me vështirësi financiare pa ndikuar në historia e kredisë. Për të mbështetur këtë nxitje, BQK-ja u dha udhëzime bankave mbi kriteret e zbatueshme për procesin e ristrukturimit.

  Gjatë kësaj periudhe, banka ka kryer vlerësim për secilin klient që kërkon ristrukturimin e ekspozimit të tyre të kredisë, ku kapaciteti financiar i klientëve është analizuar dhe bazuar në rezultatet është vendosur për procesin e ristrukturimit. Për më tepër, banka monitoroi dhe komunikoi nga afër me klientët e saj në mënyrë që të sigurojë mbështetje më të mirë duke i kështilluar ata për shfrytëzimin e kësaj mundësie bazuar në vështirësitë e tyre aktuale ose të parashikuara financiare.

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

25.1 Hyrje dhe pëmbledhje (vazhdim)

Pergjigjia ndaj riskut të COVID-19 (vazhdim)

Në fillim të këtij viti, BQK-ja ka zgjeruar më tej afatin për masat lehtësuese të parashikuara për ristrukturimin e kredisë, i cili është i vlefshëm deri në fund të marsit 2021. Përmes kësaj mase synohet të mbështesë ata klientë që nuk ishin subjekt i ristrukturimit gjatë fazesse pare (shtyrja e kësteve të huasë) dhe faza e dytë (ristrukturimi i huasë) dhe ekspozimet kreditore të të cilave mund të ristrukturohen deri në 9 muaj, ose ata klientë që morën ristrukturim gjatë periudhave të mëparshme, por për më pak se 9 muaj.

Gjithashtu, bazuar në zhvillimet në sektor dhe mjedisin e përgjithshëm ekonomik, BQK-ja kishte vendosur një program për lehtësimin e mëtejshëm të disa prej kërkesave rregullatore në lidhje me likuiditetin dhe kapitalin, kryesisht për të ulur kërkesën minimale për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Këto masa do të miratohen vetëm nëse është e nevojshme dhe nëse bankat do të përballen me telashe.

COVID-19 vazhdon ende të ndikojë në punonjësit tanë, klientët dhe komunitetin e përgjithshëm dhe kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet financiare të bankës dhe operacionet e saj të biznesit. Pasiguria në lidhje me ndikimin e COVID-19 mbetet e ngritur dhe paraqet sfida dhe rreziqe të reja për bankën. Sidoqoftë, banka po monitoron nga afër evolucionin e situatës në mënyrë që të japë llogari për efektet dhe ndikimin e mundshëm në kohën e duhur.

Korniza për menaxhimin e riskut

Bordi i drejtorëve ("Bordi") ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit për menaxhimin e riskut të Bankës. Bordi ka themeluar Komitetin e Riskut, Komitetin e Auditimit, Komitetin e Burimeve Njerëzore dhe të Qeverisjes, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të bankës mbi menaxhimin e riskut në fushat e tyre specifike.

Politikat e Bankës për menaxhimin e riskut janë themeluar për të identifikuar dhe analizuar risqet me të cilat ballafaqohet Banka, për të vendosur kufizimet e duhura të riskut dhe kontrollit si dhe të monitorojnë riskun dhe respektojnë limitet. Politikat dhe sistemet për menaxhimin e riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Banka, përmes trajnimeve, procedurave dhe politikave për menaxhim, synon të zhvilloj një ambient kontrollues konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat për menaxhimin e riskut të Bankës dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e kornizës për menaxhimin e riskut në raport me risqet me të cilat përballet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës në këto funksione ndihmohet nga Departamenti për Auditimin e Brendshëm. Auditimi i Brendshëm kryen rishikimet e rregullta dhe Ad-hoc të kontrollit dhe procedurave për menaxhim të riskut, rezultati i të cilave raportohet tek Komiteti i Auditimit

Banka operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike dinamike në zhvillim e sipër. Zgjerimi i saj mund të rezultojë në implikime negative në pozicionin financiar të Bankës. Menaxhmenti i Bankës monitoron çdo ditë pozicionin e pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe implementon masa të përshtatshme në lidhje me kredi, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe riskun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet sfidave të tregut duke mbajtur një kapital dhe pozicion likuiditeti të mjaftueshëm.

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

25.2 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjeve financiare për Bankën nëse një klient apo një palë tjetër e lidhur për një instrument financiar dështon të përmbush detyrimet kontraktuale, që vijnë nga kreditë dhe paradhëniet e Bankës për klientët dhe për bankat e tjera. Me qëllim të raportimit të menaxhimit të riskut, Banka merr parasysh dhe konsolidon të gjitha elementet e ekspozimit ndaj riskut kreditor (të tilla si risku standard i huamarrësit individual, risku shtetëror dhe sektorial).

Manaxhimi I riskut kreditor

Në BPB aktualisht vlerësimi i aplikacioneve kreditore bëhet plotësisht nga "faktori njeri" dhe si autoritet është i vendosur në 2 linja aprovuese. Pjesa me e madhe këtyre vlerësimeve dhe miratimit të kredive behet nga ekspertë të vlerësimit të rrezikut kreditor të pozicionuar ne Departamentit e Riskut Kreditor dhe pjesa tjetër nga eksperte të tjerë te vendosur ne linjën e pare te biznesit e qe janë Menaxheret e Degëve për limite me te vogla deri ne maximum 30 mije euro.

Ekspozimet kreditore më të mëdha se 100 mijë Euro dhe më pak se 10% e kapitalit të klasit të parë të Bankës aprovohen nga Komiteti Qendror i Kredive, ndërsa ekspozimet mbi 10% të kapitalit të bankës duhet të aprovohen nga Bordi i Drejtorëve sipas politikave të Riskut Kreditor

Menaxhimi i Riskut është ndarë në dy departamente të veçanta, Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe Departamentin e Riskut Kreditor. Departamenti i Menaxhimit të Riskut është i organizuar në tre sektorë duke përfshirë Sektorin e Riskut Kreditor, Sektorin e Riskut të Tregut dhe Likuiditetit, si dhe Sektorin e Riskut Operacional. Departamenti i Mneaxhimit të Riskut është përgjegjës për përpilimin apo rishikimin e politikave dhe procedurave që lidhen me riskun kreditor dhe njëkohësisht është përgjegjës për procesin e vlerësimit të pronave të paluajtshme, klasifikimin e kredive dhe peshimin e mjeteve të riskut sipas Rregullores së Adekuatshmërisë së Kapitalit si dhe identifikimin e riskut kreditor që rrjedhë nga produktet/proceset e reja që involvojnë kreditimin.

Departamenti i Riskut Kreditor është përgjegjës për menaxhimin e procesit të vlerësimit të aftësisë kredimarrëse dhe kapicitetit kreditor, vlerësimin e mjaftueshmërisë së kolateralit, procesin e vendimarrjes, montorimin/menaxhimin e kredive problematike dhe jo-performuese, duke i përfshirë edhe kreditë në humbje dhe ato jashtëbilancore që menaxhohen nga kompanitë e jashtme (outsource), procesin e monitorimeve të kredive si dhe identifikimin e riskut kreditor që rrjedhë nga produktet/proceset e reja qe involvojnë kreditimin. Departamenti i Riskut Kreditor përfshin sektorin e huadhënies, monitorimit dhe sektorin e menaxhimit të vonesave (collection).

Banka ka ndjekur strategjine e përcaktuar lidhur me diversifikimin e mëtejmë të kredive dhe rritjen e portfolios kreditore sipas segmenteve të percaktuara të kredive, më saktësisht në segmentet e kredive individuale – PI, segmentin e kredive Mikro dhe Agro dhe segmentin e kredive NVM dhe Korporatë. Gjatë vitit 2020, Banka ka bërë një rritje të konsiderueshme të portfolios kreditore edhe sipas volumit edhe sipas numrit, dhe rritja kryesisht ka ardhur nga segmentet e synuara të kredive, respektivisht në segmentet e kredive PI, Mikro dhe Agro. Për të mbështetur këtë strategji të rritjes në kredi të vogla, Banka ka vazhduar me investimet në teknologji dhe infrastrukturë, rishikimin dhe përmirësimin e proceseve me qëllim të rritjes së efikasitetit, si dhe për të siguruar rritje të qëndrueshme dhe të kontrollueshme.

Segmentimi i portofolit të kredisë (hua) bazohet në llojin dhe madhësinë e subjektit (huamarrësit), dhe në përgjithësi është grupuar në klientë me pakicë dhe biznes.

Klientë me pakicë ose individë privatë (PI) janë të gjitha llojet e klientëve që kanë burimin e tyre kryesor të ripagimit nga të ardhurat si pagat, qiratë e qëndrueshme, honoraret dhe të ardhurat e tjera të verifikueshme.

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

25.2 Risku kreditor (vazhdim)

Manaxhimi i riskut kreditor (vazhdim)

Klientët e biznesit ndahen në tre segmente kryesore; Mikro, NVM dhe Korporata. Ekziston edhe një nënkategori e klientëve të agrobiznesit të grupuar si klientë Agro, të cilët shpërndahen sipas procedurave të ndarjes ndërmjet sektorëve kryesorë ne Mikro Agro dhe NVM Agro.

Klientët e biznesit konsiderohen të gjithë klientët të cilët kanë burimin kryesor të të ardhurave nga veprimtaria e biznesit. Segregimi ndërmjet segmenteve të biznesit bazohet në qarkullimin vjetor. Të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor deri në 500 mijë Euro konsiderohen si klientë Mikro.Të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor prej 501 mijë Euro deri në 2 milionë Euro konsiderohen klientë të NVM, ndërsa të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor mbi 2 milionë Euro konsiderohen si klientë Korporatë.Lidhur me kërkesat rregullatore për raportim sipas SNRF 9, banka ka miratuar forma të reja raportimi siç kërkohet nga BQK-ja me rregulloren për raportimin e bankave. Gjatë vitit 2020 banka ka zbatuar gjithashtu kërkesat nga rregullorja e re mbi ekspozimet me probleme dhe riprogramimet në përputhje me standardin IFRS 9. Banka ka marrë të gjitha masat për të bërë klasifikimet dhe për të përmbushur të gjitha kërkesat në trajtimin e kredive me probleme dhe të planifikuara.

Lidhur me llogaritjen e HPK, banka ka avancuar më tej procesin dhe automatizuar disa nga inputet, përfshirë edhe informacionin nga moduli i monitorimit për të vlerësuar RSRK (SICR).Në funksion të strategjisë së bankës për rritjen e portfolios dhe biznesit te saj në segmentet Mikro, Agro dhe NVM, Banka ka vazhduar dhe rritur edhe më tej bashkëpunimin me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore - FKGK, për sigurimin e pjesëshëm të kredive ndaj klientëve që i disburson. Aktualisht shuma e kontratave aktive me FKGK është 21.3 milionë euro. Gjatë vitit 2020, banka vazhdoi të mbante marrëdhëniet e saj me Institucione të ndryshme Ndërkombëtare Financiare (EBRD, EFSE dhe Blue ORCHARD Finance Ltd) e cila shton një tjetër shtresë shtesë sigurie në kapitalin e saj.

Në përputhje me modelin dhe strategjinë e biznesit, Banka ka vazhduar të përmirësojë procesin e rrezikut të kredisë. Në këtë drejtim, ka vazhduar me shfrytëzimin e azhurnimeve dhe zhvillimeve të aplikacioneve të reja të bëra vitin e kaluar për menaxhimin e portofolit të kredisë. Gjatë vitit 2020, dy module të reja u operacionalizuan për të përmirësuar procesin e monitorimit të kredisë dhe menaxhimin e borxheve të prapambetura, veçanërisht në këtë periudhë krize, ku këto dy funksione kishin një rol të jashtëzakonshëm në ruajtjen e cilësisë së portofolit të kredisë.Moduli i monitorimit mbulon monitorimin e ekspozimeve financiare dhe shërben si një sistem i paralajmërimit të hershëm jo vetëm për të menaxhuar dhe mbajtur klientët e krediturar, por edhe për të parandaluar dhe parashikuar përkeqësimin e kushteve financiare të klientëve.

Ndërsa moduli i menaxhimit të vonesave është zhvilluar për të mbështetur procesin e menaxhimit dhe arkëtimit të borxheve duke siguruar menaxhim të strukturuar të të dhënave, korrespondencave, alarmeve dhe njoftimeve. Kjo ka mundësuar një qasje holistike në menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e riskut kreditor.Përveç rritjes së portofolit të kredisë dhe zvogëlimit të ekspozimeve të mëdha, banka ka vazhduar të ruajë dhe mbajë cilësinë e kredisë edhe pse kishte një presion të madh nga faktorë të jashtëm që ndikuan tek klientët për shkak të Covid-19. Banka ka përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së kredisë, në lidhje me treguesin e cilësisë së kredisë - Kreditë me probleme (NPL) në vitin 2019 ishte 2.95%, ndërsa në vitin 2020 ky tregues është 2.68%.

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

25.2 Risku kreditor (vazhdim)

Manaxhimi i riskut kreditor (vazhdim)

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2020, banka ka vazhduar me rritjen e numrit të ndërmarrjeve të administrimit të borxheve, veçanërisht për huatë e vjetra në kategoritë Humbje dhe write off, në mënyrë që të përfitojmë sa më shumë nga procesi i mbledhjes.Banka rishikon të gjitha ekspozimet kreditore në baza të rregullta, përderisa klasifikimi dhe raportimi i kredive bëhet në baza mujore në harmoni me kërkesat e Bankës Qendrore.

Ekspozimet kreditore në shumë mbi 50,000 Euro rishikohen në baza tremujore përderisa po të njejtat monitorohen në baza gjashtëmujore. Ekspozimet nën 50,000 Euro monitorohen në baza vjetore dhe përfshin analizimin e gjendjes financiare të klientëve duke përfshirë edhe analizimin e gjendjes së kolateralit, ekspozimeve në Banka tjera dhe faktorë tjerë që mund të ndikojnë në performancën financiare të huamarrësit

Për shkak të Covid-19 procesi i monitorimit u zgjerua dhe u përsërite shumë shpesh veçanërisht për klientët mbi 50 mijë EUR në mënyrë që të merrni informacionin dhe azhurnimet më të fundit.

25.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë

Sipas SNRF 9, BPB do të njohë një rënie në vlerë për humbjet e pritshme të kredisë (HPK) në çdo datë raportimi për kreditë dhe paradhëniet për klientët e matur me koston e amortizuar (AC).

Përveç kredive dhe paradhënieve për klientë, BPB do të njohë gjithashtu një rënie në vlerë të matur për humbjet e pritshme të kredisë për instrumentet financiare në vijim, nëse::

1. Instrumentet e borxhit të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

2. Marrëveshjet e kredive të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;

3. Kontratat e garancioneve financiare në të cilat zbatohet SNRF 9 dhe të cilat nuk trajtohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; dhe

4. Kërkesat e qirasë që janë brenda fushëveprimit të SNK 17, Qiratë dhe të arkëtueshmet tregtare ose pasuritë e kontraktuara brenda fushëveprimit të SNRF 15.

Parimet kryesore

Matjet sipas modelit HPK pasqyrojnë modelin e përgjithshëm të përkeqësimit ose përmirësimit të cilësisë së kredisë së instrumenteve financiare, shprehur në aspektin e rritjes së ndjeshme të riskut kreditor.
Kur instrumenti financiar fillimisht gjenerohet provizioni i humbjes matet në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme 12-mujore të kredisë. Kur instrumenti i riskut të vonesës rritet ndjeshëm që nga krijimi i tij, Banka do të masë provizionin në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të përhershme të kredisë.

25. MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR (VAZHDIM)

25.2 Risku kreditor (vazhdim)

25.2.2 Vlerësimi i rënies n**ë vlerë** (vazhdim)

Modeli me tri faza

Qasja e përgjithshme e SNRF 9 për zhvlerësimin dhe njohjen e të ardhurave nga interesi mund të përmblidhet në modelin vijues me tre faza, ku transferimet nga një fazë në tjetrën varen nga ndryshimet në rrezikun e kredisë që nga fillimi deri në mospagimin e kredisë.

Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI
Kreditë e reja në origjinë, pa rënie në vlerë	Kreditë ekzistuese me rritje të ndjeshme të riskut nga gjenerimi.	Kreditë e rëna në vlerë (në vonesë)	Kreditë e rëna në vlerë (në vonesë)
Kreditë ekzistuese pa ndonjë rritje të ndjeshme të riskut			Credit impaired loans at origination
Njohja e humbjes së pritshme nga kreditë			
Humbjet e pritshme nga kreditë 12-mujore	Humbjet e pritshme nga kreditë të përhershme	Humbjet e pritshme nga kreditë të përhershme	Humbjet e pritshme nga kreditë të përhershme
Të ardhurat nga interesi			
Interesi efektiv në vlerën kontabël bruto	Interesi efektiv në vlerën kontabël bruto	Interesi efektiv në vlerën kontabël neto (kosto e amortizuar minus provizionet kreditore)	Interesi efektiv i përshtatur në vlerën kontabël neto (kosto e amortizuar minus provizionet kreditore)

Faza 1 përfshinë kreditë e reja të krijuara që nuk janë kredi të rëna në vlerë dhe kredi ekzistuese për të cilat riskut kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, në datën e raportimit. SNRF 9 kërkon që HPK-të për këto kredi të vlerësohen në baza 12 mujore duke marrë parasysh:

- probabilitetin që ekspozimet do të jenë në vonesë brenda 12 muajve pas datës së raportimit (referuar si '12 -mujori PD '), dhe
- humbja përfundimtare e pësuar gjatë jetës në rast të vonesës (referuar si 'humbje e dhënë për vonesë' ose 'KND'.

Faza 2 përfshinë kreditë që kanë pasur një rritje të konsiderueshme në riskut kreditor që nga njohja fillestare, por që nuk kanë dëshmi objektive se janë në vonesë. SNRF 9 kërkon që HPK-të për këto kredi të vlerësohen në bazë të jetës duke konsideruar:

- probabiliteti që ekspozimet do të jenë në vonesë gjatë gjithë jetës së mbetur pas datës së raportimit (referuar si 'PD të përhershme') dhe
- humbja përfundimtare e pësuar gjatë jetës në rast të vonesës.

Faza 3 përfshinë kreditë që kanë dëshmi objektive se janë në vonësë në datën e raportimit (pasuri në vonesë). SNRF 9 kërkon që HPK-ët e përhershme të vlerësohen në bazë të humbjes përfundimtare të pësuar.

POCI përfshinë kreditë e krijuara të rëna në vlerë dhe kreditë e rëna në vlerë të blera me zbritje të madhe. SNRF 9 kërkon që këto kredi fillimisht të njihen me vlerën e drejtë minus humbjet kumulative të kredisë në njohjen fillestare. HPK ri-matet në çdo datë raportimi dhe ndryshimet njihen në Pasqyrën e të ardhurave.

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

25.2 Risku kreditor (vazhdim)

25.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (vazhdim)

Modeli i humbjes së pritshme të kredisë

Për qëllimet e matjes së HPK, BPB kryen parametrimin e nevojshëm të modelit bazuar në të dhënat e vërejtura point-in-time në një nivel të detajuar të intervaleve tremujore, të cilat konsiderohen të përshtatshme për rrethanat. Llogaritjet e HPK bazohen në parametrat e mëposhtëm hyrës:

Probabiliteti i Dështimit (PD): Kjo shpreh mundësinë e vlerësimit të dështimit për kushtet ekonomike mbizotëruese në datën e raportimit, të përshtatura për të marrë parasysh vlerësimet e kushteve të ardhshme ekonomike që ka mundësi të ndikojnë në riskun e vonësës, në një horizont të caktuar kohor. Të tilla do të jenë HPK 12 mujore për kreditë e Fazës 1 dhe HPK të përhershme për kreditë e Fazës 2. Për kreditë e Fazës 3 dhe POCI PD është 1, sepse vonesa ka ndodhur.

Ekspozimi në Dështim (END Ky është një vlerësim i ekspozimit në një datë të ardhshme të vonesës, duke marrë parasysh ndryshimet e pritshme në ekspozimin pas datës së raportimit, duke përfshirë ripagesat e principalit dhe interesit dhe tërheqjen e pritshme në objektet dhe garancionet e zotuara.

Humbja e dhënë në dështim (KND): Kjo paraqet një vlerësim të humbjes që del nga një vonesë. Ajo bazohet në diferencën midis rrjedhave të parasë të gatshme të kontraktuara dhe atyre që kredidhënësi do të priste për të marrë në bazë të kushteve ekonomike aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë çdo kolateral. Zakonisht shprehet si përqindje e END.

Norma e kurimit: Kjo shpreh gjasat e daljes nga statusi i fazës 3.

Norma e diskontimit: Kjo përdoret duke e diskontuar humbjen e pritshme të kredisë në një vlerë aktuale në datën e raportimit. Aneksi 2 ofron normën e diskontimit të zbatueshme për vlerësimin e HPK.

Tabela e mëposhtme ilustron mënyrën e zbatimit të modelit në fazat e ndryshme:

Fazat	Niveli	PD	HPD	ENV
Faza 1	Përgjithshme	PD 12-mujor (përshtatur për kushtet makro-ekonomike)	Humbjet e përhershme	Ekspozimi në dështim gjatë 12 muajve të ardhshë
	Specifike	Nuk është e aplikueshme *		
Faza 2	Përgjithshme	PD të përhershme (përshtatur për kushtet makro-ekonomike)	Humbjet e përhershme	Ekspozimi në dështim gjatë jetë së mbetur
	Specifike	Nuk është e aplikueshme *		
Faza 3	Përgjithshme	PD është i barabartë me 1, sepse vonesa ka ndodhur	Humbjet e përhershme në varësi të pikës së ciklit të rikthimit	Ekspozimi në vones në datën e raportimit
	Specifike		Rrjedhat e parasë së ardhshme të diskontuara në datën e raportimit	

* Vlerësimi individual i probabilitetit të vonesës dhe humbjeve të përhershme është në vetvete e vështirë kur nuk ka dëshmi objektive të rënies në vlerë. Megjithatë, për ekspozimet e rëndësishme të klasifikuara në Fazën 1 dhe Fazën 2, BPB mund të vërtetojë që LGD vlerësohet në baza të përgjithshme për kthimin e pritshëm nga strategjia e përjashtimit të kolateralit për një kredi në vonesë.

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare
Për vitin qe ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020
(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

25.2 Risku kreditor (vazhdim)

25.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (vazhdim)

Sistemi i brendshëm i vlerësimit të bankës dhe procesi i vlerësimit të probabilitetit të vonesës

Departamenti i Riskut Kreditor të Bankës është i pavarur të zbatojë modelet e tij të vlerësimit të brendshëm. Banka zbaton modele të veçanta për portofolin e saj kyç në të cilin klientët e saj vlerësohen nga A0 në Vonesë duke përdorur notat e brendshme.

Më poshtë jepen klasifikimet e brendshme të klasifikimit të kredive të përdorura nga Banka me SNRF 9:

Vlerësimi	Vlerësimi SNRF 9	Të papaguara më 31 Dhjetor 2020	HPK 31 Dhjetor 2020	Mesatarja e PD 12 mujor	Mesatarja e KND
Standarde	A0	176,318	558	0.8%	41.1%
Standarde	A1	519	9	4.1%	43.0%
Në vëzhgim	B	13,220	1,624	26.2%	47.3%
Nën-standard	C	4,563	1,144	63.5%	46.1%
Vonesë	Vonesë	5,363	3,992	100.0%	67.3%
Gjithsej		199,983	7,327	4.8%	41.9%

Vlerësimi	Vlerësimi SNRF 9	Të papaguara më 31 Dhjetor 2019	HPK 31 Dhjetor 2019	Mesatarja e PD 12 mujor	Mesatarja e KND
Standarde	A0	173,535	295	0.6%	35.8%
Standarde	A1	4,937	53	3.0%	30.4%
Në vëzhgim	B	1,718	155	22.7%	39.8%
Nën-standard	C	1,717	342	58.0%	41.4%
Vonesë	Vonesë	5,558	4,456	100.0%	65.3%
Gjithsej		187,465	5,301	2.7%	36.2%

Kreditë e riprogramuara dhe të modifikuara

Banka ndonjëherë bën ndryshime në kushtet origjinale të kredive si një përgjigje ndaj vështirësive financiare të kredimarrësit, në vend se të marrë në posedim ose ta detyrojë mbledhjen e kolateralit.

Banka konsideron një kredi të riprogramuar kur këto modifikime jepen si rezultat i vështirësive financiare të pranishme ose të pritshme të kredimarrësit dhe Banka nuk do të kishte rënë dakord me to nëse kredimarrësi do të ishte financiarisht i shëndetshëm. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë kovenantat e vonesës, ose shqetësime të rëndësishme të ngritura nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut. Riprogrami mund të përfshijë zgjatjen e marrëveshjeve së pagesës dhe marrëveshjen e kushteve të reja të kredisë.

Banka gjithashtu rivlerëson nëse ka pasur një rritje të ndjeshme të riskut kreditor. Banka gjithashtu shqyrton nëse pasuritë duhet të klasifikohen në Fazën 3. Pasi një pasuri klasifikohet si e ristrukturuar, ajo do të jetë e ristrukturuar për periudhën provuese minimale 24-mujore. Në mënyrë që kredia të riklasifikohet nga kategoria e ristrukturuar, klienti duhet të plotësojë të gjitha kriteret e mëposhtme: Të gjitha pikat më poshtë duhet të konsiderohen si performuese;

- Periudha provuese prej dy viteve ka kaluar nga data kur kontrata e ristrukturimit është konsideruar performuese.
- Pagesa të rregullta me më shumë se një shumë e parëndësishme e principalit ose interesit janë bërë gjatë së paku gjysmës së periudhës provuese
- Konsumatori nuk ka ndonjë kontratë që është më shumë se 30 ditë në vonesë.

25. MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR (VAZHDIM)

25.2 Risku kreditor (vazhdim)

25.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (vazhdim)

Kreditë e ristrukturuara dhe të modifikuara (vazhdim)

Tabelat në vijim paraqesin një përmbledhje të pasurive të riprogramuara të Bankës:

	Faza 2			Faza 3			
31 Dhjetor 2020	Vlera kontabël bruto	Modifikimie të përhershme për T&Cs	Gjithsej kreditë përformuese të riprogramuara	Modifikimi i përhershëm për T&Cs	Gjithsej kreditë joperformuese të riprogramuara	Gjithsej kreditë e riprogramuara	Raporti i riprogramimit
Detyrimet nga bankat	-	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	-	-	-	-	-	-	-
Korporata	112,630	8,275	8,275	311	311	8,586	7.62%
Individë	87,353	80	80	29	29	109	0.13%
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientë	199,983	8,355	8,355	340	340	8,695	4.35%

31 Dhjetor 2020	Vlera bruto e kredive të riprogramuara			HPK e kredive të riprogramuara		
	Faza 2	Faza 3	Faza 2	Faza 3	Faza 2	Faza 3
Detyrimet nga bankat	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientë						
Korporata	8,275	311	8,586	1,514	162	1,676
Individë	80	29	109	18	16	34
Gjithsej kreditë dhe pradhëniet për klientë	8,355	340	8,695	1,532	178	1,710

25. MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR (VAZHDIM)

25.2 Risku kreditor (vazhdim)

25.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (vazhdim)

Kreditë e ristrukturuara dhe të modifikuara (vazhdim)

Tabelat në vijim paraqesin një përmbledhje të pasurive të ristrukturuara të Bankës më 31

	Faza 2			Faza 3			
31 Dhjetor 2019	Vlera kontabël bruto	Modifikimie të përhershme për T&Cs	Gjithsej kreditë përformuese të riprogramuara	Modifikimi i përhershëm për T&Cs	Gjithsej kreditë joperformuese të riprogramuara	Gjithsej kreditë e riprogramuara	Raporti i riprogramimit
Detyrimet nga bankat	-	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	-	-	-	-	-	-	-
Korporata	111,051	188	188	189	189	377	0.34%
Individë	76,414	37	37	13	13	50	0.06%
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientë	187,465	225	225	202	202	427	0.23%

31 Dhjetor 2019	Vlera bruto e kredive të riprogramuara			HPK e kredive të riprogramuara		
	Faza 2	Faza 3	Faza 2	Faza 3	Faza 2	Faza 3
Detyrimet nga bankat	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientë						
Korporata	188	189	377	36	164	200
Individë	37	13	50	4	7	11
Gjithsej kreditë dhe pradhëniet për klientë	225	202	427	40	171	211

25. MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR (VAZHDIM)

25.2 Risku kreditor (vazhdim)

25.2.1 Vlerësimi i rënies ne vlerë (vazhdim)

Paraqitur më poshtë është një analizë e pasurive të matura me koston e amortizuar gjatë vitit që përfundoi më 31 Dhjetor 2020

Pasuritë që duhet të maten me kosto të amortizuar	Faza 1 HPK 12-mujore	Faza 2 HPK të përhershme	Faza 3 HPK të përhershme	Gjithsej
Vlera kontabël bruto sipas llojit të pasurive				
Agro	12,596	1,812	538	14,946
Korporatë	45,889	8,753	3,133	57,775
Kartelat kreditore	76	2	42	120
Konsumuese	24,501	707	357	25,565
Mikro	33,276	5,604	1,029	39,909
Hipotekare	51,513	843	228	52,584
Veteranët dhe invalidët	8,986	62	36	9,084
Gjithsej vlera kontabël bruto	176,837	17,783	5,363	199,983
Lejimi i humbjes sipas SNRF 9 sipas llojit të pasurive				
Agro	(72)	(257)	(229)	(558)
Korporatë	(229)	(1,582)	(2,605)	(4,416)
Kreditë kartela	(2)	(0)	(31)	(33)
Konsumuese	(49)	(101)	(234)	(384)
Mikro	(134)	(676)	(721)	(1,531)
Hipotekare	(79)	(151)	(169)	(399)
Veteranët dhe invalidët	(1)	(1)	(4)	(6)
Gjithsej lejimi i humbjes sipas SNRF 9	(566)	(2,768)	(3,993)	(7,327)

25. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

25.2 Risku kreditor (vazhdim)

25.2.1 Vlerësimi i rënies ne vlerë (vazhdim)

Paraqitur më poshtë është një analizë e pasurive të matura me koston e amortizuar gjatë vitit që përfundoi më 31 Dhjetor 2019:

Pasuritë që duhet të maten me kosto të amortizuar	Faza 1 HPK 12-mujore	Faza 2 HPK të përhershme	Faza 3 HPK të përhershme	Gjithsej
Vlera kontabël bruto sipas llojit të pasurive				
Agro	15,764	155	278	16,197
Korporatë	52,349	2,239	4,003	58,591
Kartelat kreditore	86	12	27	125
Konsumuese	26,572	242	238	27,052
Mikro	34,769	598	897	36,264
Hipotekare	37,765	172	103	38,040
Veteranët dhe invalidët	11,167	17	12	11,196
Gjithsej vlera kontabël bruto	178,472	3,435	5,558	187,465
Lejimi i humbjes sipas SNRF 9 sipas llojit të pasurive				
Agro	(35)	(14)	(61)	(110)
Korporatë	(139)	(355)	(3,574)	(4,068)
Kreditë kartela	(2)	(1)	(23)	(26)
Konsumuese	(47)	(30)	(139)	(216)
Mikro	(93)	(83)	(577)	(753)
Hipotekare	(31)	(14)	(81)	(126)
Veteranët dhe invalidët	(1)	(0)	(1)	(2)
Gjithsej lejimi i humbjes sipas SNRF 9	(348)	(497)	(4,456)	(5,301)

Më poshtë është dhënë një analizë e kolateralit dhe rritjes së kredisë të përfituar gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2020:

	Ekspozimi bruto	Lejimet e rënies në vlerë	Vlera kontabël	Vlera e drejtë e kolateralit të mbajtur
Kreditë individuale:				
